



IOM International Organization for Migration
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

PAKETË INFORMUESE PËR NORVEGJINË

1. Informacioni bazë

Kryeqyteti:	Oslo
Popullsia:	4 640 219 (Jan 2006)
Sipërfaqja:	385 155 Km ²
Monedha:	Korona norvegjeze (NOK)
Niveli i papunësisë:	2.4 %

2. Kushte të përgjithshme të hyrjes dhe informacioni për vizë

I gjithë informacioni gjendet në Drejtorinë e Norvegjisë për Migracionin:
<http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=4477>

Viza Shengen

Norvegjia është vend anëtar i zonës Shengen dhe prandaj jep viza Shengen.

Vizat Shengen mundësojnë që mbajtësi i tyre të hyjë në të gjithë Zonën e Shengenit.¹ Pas hyrjes në Zonën Shengen ju mund të udhëtoni në të gjitha vendet e Shengenit pa vizë tjetër apo kontroll pasaporte, por duhet të jenë në gjendje të vërtetoni statusin e vizës kur ju kërkohet.

Kush ka nevojë për vizë?

¹ Shengen i referohet një grupi shtetesh europiane që kanë hequr kontrollat e pasaportave në kufijtë e tyre të brendshëm dhe kanë forcuar kontrollat në kufijtë e tyre të jashtëm. 24 shtetet anëtare të Zonës së Shengenit që nga 2008 janë Austria, Belgjika, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Norvegjia, Polonia, Sllovakia, Sllovenia, Portugalia, Spanja dhe Suedia

Kjo paketë informuese u përgatit në kuadër të projektit AENEAS 2006: Ndërtimi i Kapaciteteve, Informacion dhe Ndërgjegjësim për Promovimin e Migracionit të Rregullt në Ballkanin Perëndimor të financuar nga Bashkimi Europian dhe të bashkë-financuar nga Zyra Federale Zvicerane për Migracionin, Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët, Ministria Italiane e Punëve të Jashtme/Bashkëpunimi Italian për Zhvillim dhe Qeveria e Lihtenshtejn.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Federal Office
for Migration
and Refugees



GOVERNMENT
OF LIECHTENSTEIN

Me përjashtim të shtetasve kroatë, të gjithë shtetasit e tjerë në rajon (Shqipëria, Bosnja&Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia, Kosova) kanë nevojë për vizë që të hyjnë në territorin e Shengenit.

Nëse jeni shtetas i huaj që ju duhet vizë duhet të keni gjithmonë një të tillë për të hyrë në zonën e Shengenit. Nëse do t'ju duhet vazhdimisht vizë, por keni leje të vlefshme qëndrimi në një nga vendet e Shengenit, nuk ju nevojitet vizë për të hyrë në një vend tjetër të Shengenit nëse kohëzgjatja juaj e qëndrimit është më pak se tre muaj.

Lloji i vizës që kërkonti varet nga qëllimi i vizitës tuaj. Kushtet për të marrë vizë dhe periudha e vlefshmërisë të vizës ndryshojnë sipas llojit të vizës.

Një vizë për vizitorë ju jep të drejtën të qëndroni në çdo rast vetëm deri në 90 ditë gjatë një periudhe gjashtë mujore. Nëse synimi juaj është të qëndroni më shumë se 90 ditë, atëherë duhet të aplikoni për një leje qëndrimi.

Për më shumë informacion shihni: <http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=7403>

Ku të aplikoj për vizë?

Viza Shengen duhet të kërkohet nga ambasada ose konsullata norvegjeze në vendin tuaj. Nëse vendi nga ku po aplikoni për vizë nuk ka ambasadë ose konsullatë norvegjeze, ju duhet të aplikoni për atë tek misioni norvegjez më i afërt me vendin tuaj.

Ambasada norvegjeze në Bosnjë Hercegovinë

Ambasada e Norvegjisë, Ferhadija 20, 71000 Sarajevo.

Tel: +387 33 25 40 00. Fax: +387 33 66 65 05

E-mail: emb.sarajevo@mfa.no

Orari i punës për ambasadën:

E hënë – E premte 08:30 - 16:00 (15 shtator - 14 maj)

E hënë – E enjte 08:30 - 16:00, E Premte 08:30 - 15:00 (15 maj - 14 shtator)

Orari i punës për Seksionin Konsullor:

E hënë – E premte 10:00 - 12:00

E mërkurë Mbyllur

Ambasada norvegjeze në Kroaci

Petrinjska 9, 10 000 Zagreb

Orari i punës:

08.30 – 16.00 Nga e hëna në të premte (15 shtator – 14 maj)

08.30 – 15.00 (15. maj - 14. shtator)

Orari për vizat: 10.00 – 12.00

Në ditët e punës ndërmjet Krishtlindjes dhe Vitit të Ri, Ambasada do të punojë me orar të reduktuar.

Tel: +385 1 492 2831

E-mail: emb.zagreb@mfa.no

Numër për raste urgjente (pas orarit të punës): +385 (0) 99 606 5050

Ambasada norvegjeze në Serbi

[* Ambasada në Beograd trajton gjithashtu çështje që lidhen me Malin e Zi]

Uzicka 43, Dedinje, Beograd

Telefon +381 (0)11 36 70 404 / 405, fax +381 (0)11 36 90 158.

[Për telefonata nga Mali i Zi, numri i telefonit direkt për informacion të përgjithshëm me çmimin e një thirrjeje lokale, është 069 011 200.]

Orari i punës është nga 9:00 deri në 16:00, (Nga e hëna në të premte). Orari i punës në periudhën 01 korrik - 31 gusht është 9:00 deri në 15:00.

E-mail: emb.belgrade@mfa.no

Orari për vizat: 10.00-12.00 (Nga e hëna në të premte, përveç të mërkurës kur seksioni i vizave është i mbyllur). Për informacion për viza ju lutem telefononi +381 (0)11 36 72 159 çdo ditë nga ora 09.00 deri në 10.00.

Ambasada norvegjeze në Maqedoni

8-ma Udarna brigada br. 2, 1000 Skopje

E-mail: embskp@mfa.no

Orari për vizat: 10.00-12.00 Nga e hëna në të enjte.

Telefoni për VIZA: +389 (0)2 3238525

Kërkesat në telefon për viza mund t'i bëhen direkt Seksionit të Vizave (tel.: +389 (0)2 3238525, nga e hëna në të enjte 14.00 - 15.00 ose me e-mail)

Ambasada e Danimarkës në Tiranë (Shqipëri) trajton aplikimet për vizë për të pesta vendet nordike.

<http://www.ambtirana.um.dk/en/servicemenu/News/EmbassyHandlesVisasForNordicCountries.htm>

Rr. Nikolla Tupe No. 1, 4th Fl. Apt. 4, Tirana.

Tel. +355 (4) 22 80 600

tiaamb@um.dk

Orari i Punës

E hënë – E enjte: 8.00-16.00

E premte: 8.00-14.00

Vizat: E hënë, E mërkurë, E enjte (9.00-12.00)

Si të aplikoj për vizë?

Për të marrë vizë duhet të paraqisni:

- Një pasaportë të vlefshme të paktën 90 ditë pas periudhës për të cilën keni kërkuar një vizë
- Dokument që vërteton se keni fonde të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit në Norvegji. Si rregull, duhet të keni 500 NOK për një ditë, për periudhën që ju do të qëndroni në Norvegji, por nëse do të qëndroni me familjen apo miqtë, shuma është disi më e vogël. Në disa raste, është e mjaftueshme një garanci financiare për qëndrimin dhe udhëtimin e kthimit të lëshuar nga personi që do të vizitoni (deklarata e garancisë: <http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=7406>)
- Dokument që vërteton se keni të drejtën ligjore për t'u kthyer në vendin tuaj të origjinës ose një vend tjetër ku keni një leje qëndrimi
- Dokument që vërteton se synoni të largoheni nga Norvegjia kur të mbarojë afati i vizës. Nëse autoritetet norvegjeze kanë arsye të besojnë që ju do të qëndroni në Norvegji ose në vend tjetër Shengen përtej periudhës për të cilën aplikoni për vizë, aplikimi juaj për vizë do të refuzohet.
- Dokument që vërteton se nuk jeni të regjistruar në Sistemin e Informacionit Shengen si një person i padëshirueshëm në ndonjë nga vendet e Shengenit. Kjo vlen, për shembull, për personat që janë përjashtuar nga një vend për shkak të një veprimtarie kriminale
- Dokument që vërteton se keni siguracion udhëtimi/shëndetësor që mbulon shpenzimet e kthimit të mundshëm në vendin e origjinës për shkak të arsyeve shëndetësore si dhe trajtim të menjëhershëm nga një doktor ose në një spital. Sigurimi duhet të jetë i vlefshëm për të gjitha vendet e Shengenit dhe të mbulojë të paktën 30 000 euro. Dokumentacioni i këtij sigurimi duhet të dorëzohet kur të jepet viza

Cfarë lloj vizash ekzistojnë?

<http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=7404#C#C>

Vizë transiti në aeroport (lloji A)

Personat nga vende të caktuara që do të bëjnë një ndalesë të ndërmjetme në Norvegji gjatë rrugës për një vend që nuk është palë e Marrëveshjes Shengen kanë nevojë për një vizë të veçantë transiti në aeroport. Kjo vizë vetëm lejon mbajtësin e saj të qëndrojë në zonën ndërkombëtare të transitit në aeroport, jo të hyjë në Norvegji.

Vizë transiti (Iloji B)

Personave që i nënshtrohen kërkesës për vizë të cilët synojnë të udhëtojnë përmes një ose më shumë vendeve Shengen mund t'ju jepen viza transiti e vlefshme deri në pesë ditë. Kjo vlen vetëm kur personi hyn nga një vend që nuk është palë e Marrëveshjes Shengen dhe do të dalë në një vend tjetër që nuk është palë e Marrëveshjes.

- Aplikantët që kërkojnë vizë transiti për në Norvegji janë shtetasit e huaj që i nënshtrohen kërkesës për vizë të cilët synojnë të udhëtojnë nga Svalband në një vend jashtë zonës Shengen. Ndërsa për aplikime të tjera për vizë, aplikimet për vizë transit duhet të bëhen duke përdorur formularin e duhur të aplikimit dhe të paraqiten në misionin më të afërt të huaj të shërbimit
- Aplikantët të tjerë që mund të kenë nevojë për vizë transit përfshijnë detarët që do të hyjnë ose dalin nga mjeti lundrues në një port norvegjez, ose detarët që do të udhëtojnë përmes Norvegjisë në një vend jashtë zonës Shengen.

Vizë vizitori (Iloji C)

Një vizë vizitori mund të jepet nëse synoni të udhëtoni në Norvegji për turizëm, vizitë familjare, biznes publik apo udhëtim pune, vizitë studimore apo punë tjetër. Një vizë për në Norvegji dhe në zonën Shengen mund të jepet për deri në 90 ditë. Megjithatë, nuk mund të qëndroni në zonën Shengen për më shumë se 90 ditë në periudhën prej gjashtë muajsh. Kjo do të thotë që çdo qëndrim në zonën Shengen në gjashtë muajt e shkuara duhet të merret parasysh kur llogaritet kohëzgjatja e një vize. Kohëzgjatja e një vize përcaktohet në vizën pullë. Viza pullë gjithashtu përcakton datën e parë të lejuar të hyrjes dhe datën e fundit të lejuar të daljes.

Drejtoria e Emigracionit ka zhvilluar një llogaritës vize që mund të llogarisë kohëzgjatjen maksimale të vizës tuaj: <http://www.udi.no/templates/VisumKalkulator.aspx?id=2083>

Një vizë përgjithësisht lëshohet për një hyrje të vetme. Nëse aplikanti planifikon të udhëtojë jashtë zonës Shengen dhe të kthehet brenda periudhës së vizës, kutia "Dy hyrje" ose "Shumë Hyrje" duhet të zgjidhet në formularin e aplikimit për vizë.

Aplikimi duhet të shoqërohet me një shpjegim pse janë të nevojshme dy ose më shumë hyrje.

Nëse lind nevoja për një hyrje shtesë pas mbërritjes në Norvegji, ky aplikim bëhet nëpërmjet policisë në të njëjtën mënyrë si një aplikim për kohëzgjatjen e vizës. Aplikanti duhet të jetë në gjendje të dokumentojë arsyen e tij/saj për një hyrje shtesë (p.sh. për një takim pune, ose për vizitë familjare jashtë zonës Shengen)

Një vizë nuk i jep të drejtë mbajtësit të saj të punojë ose të kryejë veprimtari tregtare gjatë vizitës së tyre. Personat që dëshirojnë të punojnë ose të qëndrojnë për një periudhë të zgjatur në Norvegji duhet të aplikojnë për një leje specifike për këtë gjë. Personat me punë afatshkurtër në Norvegji (që nuk kalon tre muaj) nuk kanë nevojë për leje pune. Shih më shumë informacion në <http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=7361> dhe në seksionin 2 më poshtë.

Formulari i aplikimit (viza Shengen): <http://www.udi.no/templates/PageURL.aspx?id=7524>

Vizë për të aplikuar/pritur për një vendim për aplikimin për imigracion familjar (Iloji D)

Nëse dëshironi të merrni një leje për imigracion familjar, si rregull duhet të keni marrë leje përpara se të hyni në Norvegji. Megjithatë, në rrethana të caktuara mund të hyni në Norvegji përpara dhënies së një leje. Në këtë rast, ju duhet të merrni një vizë hyrjeje nëse i nënshtroheni kërkesës për vizë. Një vizë e tillë do të jepet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.

Personat e mëposhtëm mund të aplikojnë për një vizë hyrjeje:

- Bashkëshorti/bashkëshortja i një shtetasi norvegjez që jeton në Norvegji ose që planifikon të vendoset atje
- Bashkëshorti/bashkëshortja e një shtetasi nordik që ka jetuar në Norvegji tre vitet e shkuara dhe bashkëshortët janë martuar që prej të paktën tre vjetësh
- Bashkëshorti/bashkëshortja e një shtetasi të huaj që ka një leje vendosjeje dhe bashkëshortët kanë qenë të martuar që prej të paktën tre vjetësh
- Bashkëshorti/bashkëshortja e një shtetasi të huaj që ka një leje individuale për të punuar në një grup dhe bashkëshortët kanë qenë të martuar që prej të paktën tre vjetësh

Fëmijët që ju dhe bashkëshorti/bashkëshortja juaj keni pasur së bashku dhe që nuk janë shtetas norvegjezë, duhet të aplikojnë për vizë hyrjeje.

Fëmijët e aplikantit nga një partner i mëparshëm që dëshiron të kërkojë imigracion familjar duhet të aplikojnë nga vendi i tyre i origjinës.

Ju lutemi të jeni në dijeni që nuk do të keni të drejtë për arsimim, pagesa për mësimin e gjuhës norvegjeze ose përfitime të tjera ndërsa jeni në pritje për një aplikim për herë të parë për një leje për imigracion familjar që është në shqyrtim. Gjithashtu nuk ju lejohet të punoni ndërsa aplikimi juaj shqyrtohet, nëse nuk ju është dhënë një leje pune të përkohshme.

Dhënia e një vizë hyrjeje nuk ka ndikim në rezultatin e një aplikimi për një leje për imigracion familjar.

Vizë për persona që marrin leje qëndrimi ose leje pune

Nëse ju jepet një leje qëndrimi ose pune për në Norvegji, ju automatikisht merrni gjithashtu një leje hyrjeje që u jep të drejtën të qëndroni në Norvegji për shtatë ditë. Prandaj nuk keni nevojë të aplikoni për një vizë si të tillë. Gjatë periudhës shtatë-ditore, duhet të kontaktoni policinë për të marrë një pullë në pasaportën tuaj ose një dokument udhëtimi që tregon se ju keni një leje pune ose qëndrimi në Norvegji.

Për informacion të mëtejshëm për leje pune dhe qëndrimi për Norvegji shihni: <http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=4479> dhe Seksionin 2 dhe 5 më poshtë

Vizë për të kërkuar punë në Norvegji (punëtorët e kualifikuar/specialistët)

Nëse ju cilësoheni si punëtor i kualifikuar/specialist, mund të merrni një vizë nëse keni një ofertë punësimi në Norvegji, ose dëshironi të kërkonit punë këtu. Kërkesat për një vizë të tillë varen nëse ju keni apo jo një ofertë punësimi.

Nëse nuk keni ofertë punësimi, mund të merrni një vizë nëse keni trajnim ekuivalent ose të paktën nivelin e arsimimit të mëtejshëm.

Nëse keni një ofertë punësimi në Norvegji, aftësitë e mëposhtme mund të merret parasysht në vend të trajnimit formal:

- Kurs ose trajnim tjetër në një shoqëri jashtë vendi. Për një marrë një vizë, trajnimi duhet të sigurojë të njëjtin nivel ekspertize si një formim profesional formal dhe ekspertiza duhet të ketë lidhje me punën që do të filloni
- Kualifikime të bazuara në përvojën praktike në një fushë të veçantë. Për të marrë një vizë, përvoja praktike duhet të jetë të paktën po aq e gjatë sa formimi profesional formal që jep të njëjtën ekspertizë dhe ekspertiza duhet të ketë lidhje me punën që do të filloni

Vizë kombëtare vizitori

Në rast se nuk mund të merrni një vizë vizitori për gjithë zonën e Shengenit, mund të jetë e mundur, në disa rrethana specifike, të lëshohet një vizë kombëtare vizitori. Një aplikant mund t'i jepet një vizë që është e vlefshme vetëm për Norvegjinë kur kjo vizë kërkohet për arsye humanitare, konsiderata kombëtare apo

detyrime ndërkombëtare. Në këto raste, Drejtoria Norvegjeze për Imigracion (UDI) vendos për aplikimin që duhet të paraqitet në misionin e huaj më të afërt, si për rastin e aplikimit për çdo lloj tjetër vize.

Vizë VLTV (Vizë me Vlefshmëri të Kufizuar Territoriale)

Një vizë me vlefshmëri të kufizuar territoriale mund t'ju jepet aplikantëve që kanë një dokument udhëtimi i cili nuk është i vlefshëm për hyrje në disa vende Shengen. Viza e lëshuar është e vlefshme për vende ku dokumenti i udhëtimit është i vlefshëm.

Formular aplikimi (viza Shengen): <http://www.udi.no/templates/PageURL.aspx?id=7524>

Vizë për raste urgjente

Personat që i nënshtrohen kërkesës për vizë, të cilët arrijnë në Norvegji pa vizë, mund të marrin një vizë për raste urgjente nëse është e paparashikuar dhe për arsye të detyrueshme. Personat që i nënshtrohen kërkesës për vizë të cilët arrijnë në Norvegji pa vizë të vlefshme duhet të kontaktojnë policinë në kufi për të aplikuar për një vizë për raste urgjente. Vizat për raste urgjente mund të jepen vetëm në raste të jashtëzakonshme, sipas kriterëve të rrepta. Rrjedhimisht, shumë persona që vijnë në Norvegji pa vizë dërgohen menjëherë në vendin e tyre.

Shembuj të arsyeve të bazuara:

- Kur ju njoftojnë që një anëtar i afërt i familjes në Norvegji ka pësuar një aksident të rëndë por misioni i shërbimit të huaj norvegjez është i mbyllur atë ditë dhe ju duhet të largoheni menjëherë për Norvegji
- Kur ju duhet të merrni pjesë në aktivitete të organizuara në Norvegji për të cilat sapo jeni njoftuar, por misioni i shërbimit të huaj norvegjez është i mbyllur atë ditë dhe ju duhet të largoheni menjëherë për në Norvegji
- Kur jeni një detar që hipni apo zbrisni nga një mjet lundrimi në ujërat norvegjeze, por misioni i shërbimit të huaj norvegjez është i mbyllur atë ditë dhe ju duhet të largoheni menjëherë

UDI vendos për aplikimet për vizat për raste urgjente pas kontaktimit me policinë. Vizat për raste urgjente jepen si viza të zakonshme vizitori nëse kërkesat për këtë të fundit janë plotësuar. Nëse kërkesat për një vizë të zakonshme vizitori nuk plotësohen, një vizë për raste urgjente mund të jepet si një vizë kombëtare vizitori, nëse ka arsye të bazuara.

Formular aplikimi (viza Shengen): <http://www.udi.no/templates/PageURL.aspx?id=7524>

Përrjashtimet nga kërkesa për vizë

- Personat me një leje pune, leje qëndrimi ose leje vendosjeje norvegjeze. Leja duhet të regjistrohet në dokumentin e udhëtimit të mbajtësit
- Mbajtësit e një dokumenti udhëtimi refugjati të lëshuar nga Malta, Irlanda, Lihtenshtein, Zvicra apo MB
- Mbajtësit e një pasaporte britanike me një largim/leje të pakufizuar/papërcaktuara për të hyrë dhe qëndruar në MB
- Mbajtësit e një "Dokumenti Udhëtimi për raste Urgjente" britanik kur personi është transit në Norvegji dhe dokumenti i udhëtimit për raste Urgjente përcakton që destinacioni i udhëtimit është MB
- Mbajtësit e një pasaporte gjermane për raste urgjente "*Reiseausweis als Passersatz zur Rückkehr in die Bundesrepublik Deutschland*" kur personi është transit në Norvegji dhe dokumenti i udhëtimit për raste urgjente përcakton që destinacioni i udhëtimit është Gjermania
- Mbajtësit e një dokumenti udhëtimi të detarëve të lëshuar nga: Australia, Belgjika, Bosnja dhe Hercegovina, Kanadaja, Kroacia, Danimarka, Franca, Gjermania, Irlanda, Italia, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mauritius, Monako, Maroku, Holanda, Zelanda e Re, Norvegjia, Portugalia, Serbia dhe Mal i Zi, Sllovenia, Suedia, Zvicra ose MB

- Mbjtësit e një karte identiteti detari të lëshuar nga një shtet që është nënshkruar i Konventës ILO nr 108 kur mbajtësi synon të fillojë ose të lerë postin në bordin e një mjeti lundrimi në një port norvegjez, ose është anëtar i ekuipazhit në një mjet lundrimi ose dëshiron të vizitojë portin gjatë lejes për t'u larguar nga bregu
- Mbjtësit e një licence të aviacionit civil kur mbajtësi synon të udhëtojë në Norvegji dhe të qëndrojë në vend në lidhje me punën brenda aviacionit ndërkombëtar
- Mbjtësit e një "Regjistri dhe Identifikimit të Detarit" filipinez dhe/ose një pasaportë kombëtare filipineze (kur mbajtësi do të marrë një vend në bordin e anijes në një port norvegjez)
- Refugjatët e aprovuar, personat pa shtetësi dhe të tjerë pa shtetësi, por rezidentë në një vend tjetër të BE-së që kanë dokument udhëtimi të lëshuar nga ai vend
- Nxënësit që shkojnë në shkollë të cilët janë rezidentë në një vend të BE që ka zbatuar Vendimin e Këshillit 94/795 gjatë udhëtimit në një ekskursion shkolle të shoqëruar nga mësuesit e shkollës

Kërkesat për shtetasit që nuk kanë nevojë për vizë

Nëse jeni i përjashtuar nga kërkesa për të marrë vizë për në Norvegji, mund të qëndroni në Norvegji deri në 90 ditë. Nuk mund të qëndroni në Norvegji më shumë se 90 ditë gjatë 180 ditëve të shkuara. Kjo do të thotë që, pas një qëndrimi prej 90 ditësh, nuk mund të ri-hyni në Norvegji deri në kalimin e 90 ditëve të tjera. Përgjegjësia juaj është të siguroheni që plotësoni këtë kërkesë.

Mund të përdorni llogaritësin e vizës të UDI-t për të llogaritur sa ditë më shumë mund të qëndroni në zonën Shengen: <http://www.udi.no/templates/VisumKalkulator.aspx?id=2083>

Për shtetasit e huaj që nuk kanë nevojë për vizë vlejné disa kërkesa. Ju duhet të keni:

- Fonde të mjaftueshme për të mbuluar qëndrimin tuaj në Norvegji. Si rregull, duhet të keni 500 NOK për një ditë gjatë gjithë qëndrimit në Norvegji, por nëse do të qëndroni me familje ose miq, shuma është disi më e ulët
- Një pasaportë që është e vlefshme për të paktën tre muaj pas periudhës së qëndrimit tuaj në Norvegji
- Të drejtën ligjore për t' u kthyer në vendin tuaj të origjinës ose një vend tjetër ku keni leje qëndrimi

Pyetje të tjera për vizat?

Kontakttoni Shërbimin e Informacionit (OTS).

Telefon: (+47) 23 35 16 00

E-mail: ots@udi.no

Orari i punës: 09:00 - 15:30

(nga 15 maji deri në 14 shtator: 09.00 - 15.00)

3. Imigracioni për qëllime punësimi

Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të punëtorëve të huaj

Si rregull i përgjithshëm, kushdo që dëshiron të punojë në Norvegji duhet të ketë një **lejë pune**. Puna përfshin të gjitha llojet e punës ose veprimtarisë tregtare, të paguar apo jo.

Më poshtë është një përmbledhje e grupeve që **përjashtohen** nga kërkesa për të marrë një leje pune.

- a) Grupet e mëposhtëm janë tërësisht të përjashtuar nga kërkesa për të marrë një leje pune:
 - Shtetasit nordikë
 - Detarë të huaj në mjete të huaja lundrimi të regjistruara që transportojnë mallra ose pasagjerë ndërmjet porteve norvegjeze

- b) Grupet e mëposhtme janë të përjashtuar nga kërkesa për të marrë një leje pune, nëse puna zgjat jo më shumë se tre muaj:
- Tregtarë dhe biznesmenë (Shihni Qarkoren 2000-036 për personat që do të shesin mallrat e tyre në panairë tregtare)
 - Kërkuesit/studentët me bursë /lektorët
 - Ekspertë teknikë që sigurojnë mirëmbajtje ose informacion për makineri (duhet të njoftojnë policinë me shkrim përpara hyrjes në vend)
 - Çdo shtetas i huaj në shërbimin privat të personave që vizitojnë the vendin për një periudhë që nuk kalon tre muaj. Me fjalë të tjera: nëse punoni në shërbimin privat të një personi dhe ndiqni këtë person për vizitë të shkurtër në Norvegji, mund të vazhdoni të punoni në një shërbim privat gjatë qëndrimit
 - Sportistë dhe sportiste profesioniste
 - Nëpunësit publikë të paguar nga vendi i tyre, kur vijnë në Norvegji në bazë të një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet vendit të tyre dhe autoriteteve norvegjeze
 - Gazetarët
 - Guidat e udhëtimit
 - Staf i në trena, avionë, autobusë ose kamionë të huaj
 - Ekuipazhi i sigurisë dhe mirëmbajtjes në një anije të ndaluar në vend. Këta duhet të njoftojnë policinë përpara hyrjes në Norvegji, shihni Qarkore 2002-063
- c) Grupet e mëposhtme janë të përjashtuara nga kërkesa për të marrë një leje pune, nëse puna nuk kalon dhjetë ditë në çdo një vit kalendarik:
- Muzikantë
 - Performues
 - Artistë
 - Asistentë të nevojshëm shoqëruar

Migrantët për motive punësimi që nga 1 janari 2008 mund t'ju referohen rregullave më të lehta

<http://www.udi.no/templates/Page.aspx?id=8993>

Thjeshtimi e bën të lehtë për punëdhënësit të rekrutojnë punonjës të huaj dhe në masë të gjerë të përdorin forcën e punës që ndodhet tashmë në vend. Ndryshimet vijnë si rezultat i ndryshimeve në rregullat e Ministrisë së Punës dhe Përfshirjes Sociale (AID).

Ndryshimet nënkuptojnë tre ndryshime për punëtorët e e kualifikuar/specialistë nga jashtë zonës BE/ZEE:

- Punëtorët e kualifikuar që janë në Norvegji me vizë mund të aplikojnë për një leje punë nga Norvegjia kur viza është dhënë për tre muaj ose më pak. Aktualisht, kërkohet që një vizë e tillë të lëshohet për ekzaktësisht tre muaj që këta persona të jenë në gjendje të aplikojnë për leje pune nga Norvegjia
- Policisë i është dhënë gjithashtu kompetenca për të vendosur në lidhje me aplikimet për rinovim për një punë të re ose një vend të ri pune. Arsyeja për ndryshim është që zakonisht ndodh që një punëmarrës merr një ofertë nga punëdhënësi tjetër përpara mbarimit të lejes së punës origjinale të punëmarrësit. Procedura aktuale është e tillë që një aplikim duhet të dërgohet në UDI nga policia për shqyrtim. Kjo rrit praktikisht kohën e shqyrtimit të aplikimit
- Të drejtën për të filluar punë me një punëdhënësi të ri kur është paraqitur kërkesa për rinovim të lejes

Udhëzimet nga AID do të çojnë më tej në një zbutje të marrëdhënies me punëtorë të kualifikuar/specialistë që aplikojnë për leje vendosjeje në Norvegji. Leja e vendosjes është leje që i jep mbajtësit të drejtë të jetojë përgjithmonë në Norvegji. Rregulli është i tillë që një punëmarrës mund të aplikojë për një leje të tillë pas tre vitesh, nëse ka pasur një leje pune që përbën arsyet për një leje vendosjeje. Kërkesa aktuale është që punëmarrësi duhet të ketë pasur të njëjtin punëdhënësi në këto tre vjet.

Pas udhëzimeve nga AID, legjislacioni që tani e tutje do të interpretohet në mënyrë të tillë që periudha e tre viteve nuk do të ndërpritet më kur punëmarrësi të ndryshojë punëdhënësin. Punëmarrësi duhet të vazhdojë të aplikojë për rinovim në përfundim të çdo leje, por ndryshimi i punëdhënësit nuk do të ndikojë më në mundësinë për të aplikuar për leje vendosjeje. Kushti është që, aplikanti të ketë punuar në Norvegji për tre vjet rresht.

A keni pyetje të tjera për lejet e punës?

Kontakttoni Shërbimin e Informacionit (OTS).

Telefon: (+47) 23 35 16 00

E-mail: ots@udi.no

Orari i punës: 09:00 - 15:30

(nga 15 maji deri në 14 shtator: 09.00 - 15.00)

Tregu i punës dhe sektorë të mundshëm që përjetojnë mangësi

Sektorë me nivele shumë të larta veprimtarie përfshijnë ndërtimin, industrinë (sidomos të naftës dhe ndërtimit të anijeve) dhe hotelerinë dhe restorantet. Imigracioni për punë relativisht i shtrirë ka qenë mekanizëm për të moderuar presionin në tregun e punës. Tregu i punës varion në mënyrë të konsiderueshme nga një qytet norvegjez në tjetrin. Shërbimet publike dhe të peshkimit janë sektorët dominues në pjesën veriore të Norvegjisë, ndërsa industria zë një pjesë të madhe në konte bregdetare në Norvegjinë jugore. Shumë njerëz në qytetet e Oslo-s, Bergen-it, dhe Trondheim-it punojnë në shërbime financiare dhe biznesi. Variacioni rajonal është më i vogël në sektorë të tjerë, si ndërtimi.

Sipas një studimi të 2006, numri i vendeve vakante të shpallura është rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit dhe brenda disa sektorëve të biznesit kanë lindur probleme rekrutimi. Kjo vlen për punëtorët e kualifikuar brenda industrisë së prodhimit, ndërtimit dhe sektorit ICT, sidomos në profesione si inxhinierë të kontraktuar dhe inxhinierë. Janë vërejtur gjithashtu mangësi në sektorë të kujdesit shëndetësor dhe ushqimit.

Më shumë informacion për tregun e punës në Norvegji gjendet në: NAV www.nav.no, NAV EURES (Shërbimet Europiane të Punësimit) www.eures.no dhe Portalin përgjithshëm Europian të Lëvizshmërisë për Punë www.eures.europa.eu Statistika të tregut të punës janë gjithashtu në dispozicion nga Statistikat në Norvegji: www.ssb.no

Kërkimi për punë

Internet:

- EURES:
<http://europa.eu.int/eures/main.jsp?catId=7920&acro=living&lang=en&parentId=7724&countryId=NO&living=>
- Shumica e vendeve vakante në Norvegji shpallen në internet. Banka më e madhe e të dhënave për vende vakante është NAV (*Arbeids- og velferdsetaten* [Organizata Norvegjeze e Punës dhe Mirëqenies]) faqe interneti: <http://www.nav.no/page?id=805312736>
- Vendet vakante në Norvegji mund të gjenden gjithashtu në faqen e internetit Europaportalen: <http://www.europaportalen.se/>
- Gjithashtu, shumica e kompanive kanë faqet e tyre të internetit. Mund të gjeni vende vakante në të cilat nuk janë shpallur në vend tjetër. Përdorni 'Gule Sider' [Faqet e Verdha] për të gjetur adresat.

Qendra e Shërbimit NAV

Telefononi +47 800 33 166 (E hënë – E premte, 08.00 – 18.00) për informacion për vende vakante. Ky shërbim mund të dërgojë gjithashtu njoftime pune që mund të jenë me interes, por këto janë vetëm në norvegjisht. Konsideroni çfarë lloj pune ju doni dhe ku doni të jetoni dhe të punoni në Norvegji përpara se të telefononi.

Gazeta

Shumë gazeta shpallin vende vakante. Më e madhe është gazeta Aftenposten dhe botimi i saj i të dielës ka një suplement të veçantë për punë ku vendosen të gjitha njoftimet gjatë javës së shkuar.

Kërkimet e hapura për punë

Për vendet vakante që nuk janë shpallur ka një treg të madh. Këto vende vakante mund të gjenden duke dërguar aplikime pune në kompanitë përkatëse. Është e rëndësishme që aplikimi të shoqërohet me një telefonatë. "Gule Sider" Fletët e verdha përmbajnë informacion kontakti për kompanitë kryesore.

Agjencitë e Rekrutimit

Mund të regjistroheni në një agjenci rekrutimi. Këto agjenci rekrutojnë punonjës për pozicione të përkohshme në nivel të parë. Disa prej tyre janë të specializuara në profesione të veçanta dhe industri. Këto mund të gjenden në "Gule sider" [Fletët e Verdha].

Au-pair dhe programe të tjera specifike pune për të huajt

Puna me kohë të pjesshme

Si student në një institucion të njohur në nivel universitar në Norvegji, normalisht ju jepet një leje pune me kohë të pjesshme së bashku me lejen e qëndrimit për herë të parë. Kur të aplikoni për rinovim të lejes së studentit, duhet të përfshini një deklaratë nga ofruesi i arsimit që puna nuk pengon studimet tuaja. Për më shumë informacion shihni: <http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=7381>

Skema au-pair

Qëllimi i skemës *au pair* është t'u japë të rinjve nga mosha 18 deri në 30 vjeç një mundësi për të mësuar norvegjisht dhe për t'u njohur me kulturën norvegjeze nëpërmjet jetesës dhe pjesëmarrjes në jetën e përditshme të një familjeje norvegjeze. Për më shumë informacion shihni: <http://www.udi.no/templates/Rundskriv.aspx?id=8960>

Kontrata e punësimit, e nënshkruar nga *au pair* dhe familja pritëse, rregullon kushtet e punës së *au pair*, dhe i jep *au pair* të drejtat e mëposhtme:

- Pagesë minimale/para xhepit 4000 NOK bruto (përpara zbritjes së taksave) në muaj përveç ushqimit dhe akomodimit
- Maksimumi 30 orë pune në javë. Një *au pair* nuk mund të punojë normalisht për më shumë se pesë orë në ditë. Puna mbi këtë numër orësh është e ndaluar, edhe nëse paguhet shtesë
- *Au pair*-ët lejohet të punojnë vetëm për familjen e tyre pritëse dhe nuk mund të punojnë për punëdhënës të tjerë apo persona privatë
- Një *au pair* duhet të jetojë në shtëpinë e familjes pritëse ku duhet të ketë një dhomë të vetën
- E drejta për pushim në përputhje me Aktin e Ambientit të Punës (norvegjisht) dhe aktin në lidhje me ditët e pushimit
- Një mundësi për të mësuar norvegjisht, tarifat e kursit të mësimit deri në 6000 NOK në vit që paguhet nga familja pritëse dhe një mundësi për të marrë pjesë në veprimtari argëtimi.
- As familja pritëse as *au pair* nuk mund të nënshkruajnë kontrata shtesë që bie në kundërshtim me termat dhe kushtet e kontratës standarde

Një *au pair* me leje pune do të bëhet automatikisht anëtar i Skemës Kombëtare Norvegjeze të Sigurimit. Nuk kërkohet sigurim ekstra për periudhën e një *au pair*.

Nëse një *au pair* dëshiron të ndërrojë familjen pritëse, ai/ajo duhet të paraqesë një aplikim për leje pune. *Au pair* nuk do të lejohet të fillojë punë me një familje të re pritëse derisa të nxirret një leje e re pune.

Një leje pune si *au pair* mund të rinovohet, por periudha e plotë është e kufizuar në dy vjet. Aplikime për rinovim të lejes së punës duhet të paraqitet në policinë vendore të distriktin ku jeton *au pair*.

Kontrata e punësimit mund të përfundojë nga secila palë të paktën me një muaj paralajmërim. Nëse familja pritëse e trajton keq *au pair*-in ose është fajtorë për shkelje të rëndë të detyrimeve kontraktuale, *au pair* rekomandohet të kontaktojë policinë vendore. Në këto raste, *au pair* ka të drejtë të përfundojë menjëherë kontratën.

Vetëm Drejtoria e Imigracionit ka të drejtë të shfuqizojë një leje pune. Përfundimi i kontratës nga familja pritëse nuk do të thotë që *au pair* duhet të largohet menjëherë nga Norvegjia. Drejtoria e Imigracionit ose policia do të paralajmërojnë *au pair* që po konsiderojnë shfuqizimin e lejes së punës dhe do t'i japin atij mundësi të paraqesë rastin e tij/saj normalisht brenda tre javësh. Deri në mbarim të afatit të *au pair* për të paraqitur rastin e tij /saj, *au pair* ka të drejtë të gjejë një familje tjetër pritëse dhe të paraqesë një aplikim për të punuar për atë.

4. Imigracioni për qëllime studimi

Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të studentëve

Shtetasit e huaj që dëshirojnë të studiojnë në Norvegji për më shumë se tre muaj duhet të aplikojnë për një leje qëndrimi për studentë. Faqja e internetit të Drejtorisë norvegjeze për Imigracionin përmban informacion për studimet që përbëjnë arsye për një leje qëndrimi. Ka gjithashtu informacion për mënyrën e aplikimit (<http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=7415>)

NB: Rregulla të veçanta vlejnë për studentët në shkolla të larta popullore ose kolegji kulturi.

Lejet e qëndrimit për studentë

<http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=7417>

Një leje studimi u jepet shtetasve të huaj që synojnë të qëndrojnë në Norvegji për qëllime arsimore.

Për të marrë një leje për të studiuar në Norvegji ju duhet

- Të keni një ofertë të qëndrueshme pranimit nga një institucion arsimor i njohur zyrtarisht. Një leje qëndrimi mund të jepet për llojet e mëposhtme të studimeve: arsimim në një shkollë të mesme, kurse norvegjisht dhe programe mësimore të gjuhës norvegjeze, shkolla verore universitare, shërbime të veçanta për personelin e shëndetësisë. Më shumë informacion në: <http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=7418>
- Të kryeni arsimim me kohë të plotë. Kjo do të thotë që duhet të merrni lëndë apo kurse që janë të pranueshme për mbështetje të plotë nga Fondi Shtetëror i Huasë për Arsimim (Statens Lånekasse). Kjo vlen edhe nëse synoni të financoni qëndrimin tuaj me mjete të ndryshme nga Fondi Shtetëror i Huasë për Arsimim.

- Të keni siguruar strehim. Ju duhet të keni siguruar strehimin për periudhën e studimeve. Strehimi quhet i siguruar nëse keni në përdorim një shtëpi, apartament, garsonierë, dhomë në një shtëpi etj. Nëse akomodimi merret me qira, duhet të paraqitet një kontratë me shkrim, e firmosur nga pronari, bashkëpronarët ose personi tjetër që është përgjegjës për akomodimin.
- Të keni siguruar mjetet e jetesës. Ju duhet të keni të siguruar mjetet e jetesës për periudhën e studimeve. Duhet të keni mjete financiare ekuivalente me financimin e plotë nga Fondi Shtetëror i Huasë për Arsimim në nivelin aktual. Për vitin akademik 2007-08 kjo arrin shumën 82.900 NOK. Nëse duhet të paguani tarifa shkollore, kjo shumë do t'i shtohet në kërkesën e lartpërmendur të mjeteve të jetesës

Mjetet e jetesës mund të sigurohen me një hua për studime, një grant, mjete personale ose të ardhura nga puna. Mund të aplikoni për një leje pune me kohë të pjesshme ndërkohë që jeni me studime. Të ardhurat nga kjo punë mund të merren në konsideratë kur vlerësoni nëse keni mjete të mjaftueshme për të siguruar jetesën. Nëse planifikoni të plotësoni kërkesën për mjete të jetesës tërësisht ose pjesërisht nga puna me kohë të pjesshme, duhet të paraqisni një ofertë konkrete punësimi që përcakton qartë orët e punës dhe pagën. Një leje pune jepet për punë deri në 20 orë në javë dhe me kohë të plotë në ditë pushimi. Kërkesa për mjete jetese rritet përafërsisht 100 00 NOK ndërsa të ardhurat i nënshtrohet taksave.

Përgjithësisht nuk është e pranueshme që jetesa të sigurohet me garanci financiare nga një palë e tretë, pavarësisht nëse garantuesi është në Norvegji ose jashtë. Megjithatë në raste të veçanta mund të pranohet që prindërit që jetojnë në Norvegji të garantojnë që një aplikant do të ketë ushqim dhe akomodim në shtëpinë e tyre.

Nëse keni në dispozicion mjetet tuaja, rregulli i përgjithshëm është që ju duhet të transferoni shumën në një llogari në një bankë norvegjeze në emrin tuaj, ose nëse vlen, të depozitoni shumën në llogarinë që institucioni arsimor ka krijuar për këtë qëllim. Dokumentacioni i gjendjes të llogarisë tuaj, ose konfirmimi nga institucioni arsimor që paratë mbeten në llogari, duhet të paraqitet me aplikimin.

- Gjithashtu, është kusht që ju të ktheheni në vendin e origjinës pas përfundimit të studimeve. "Vendi i origjinës" do të thotë vendi i të cilit ju jeni shtetas, ose ku ju është dhënë leje qëndrimi të përhershëm afat-gjatë.

Një përcaktim më i qartë i kushteve për lejen mund të gjendet në seksionin 4, paragrafi 1 i Rregullave të Imigracionit:

<http://www.zu.ac.ae/library/html/UAEInfo/documents/UAEImmigrationLaw.pdf>

Si të aplikoj?

Për të aplikuar për një leje qëndrimi duhet të plotësoni një formular aplikimi. Aplikimi duhet të paraqitet nga vendi juaj i origjinës ose një vend tjetër ku keni qenë rezident i ligjshëm për të paktën gjashtë muaj. Si rregull i përgjithshëm nuk mund të hyni në vend derisa të jetë dhënë leja. Aplikimi duhet të dorëzohet në misionin norvegjez të huaj të shërbimit më të afërt (ambasadë, konsullatë e përgjithshme). Ju do të informoheni gjithashtu në lidhje me aplikimin nëpërmjet misionit të huaj të shërbimit.

Megjithatë, disa persona mund të aplikojnë për leje qëndrimi nga Norvegjia. Kjo vlen për ata që kualifikohen si punëtorë të kualifikuar/specialistë, dhe ose:

- kanë një leje qëndrimi ose pune që zgjat tre muaj ose më shumë
- kanë marrë një vizë për tre muaj
- kanë të drejtë të jetojnë në Norvegji për tre muaj pa leje (pra pa kërkesë për vizë) ose
- ju është dhënë një vizë, pra një vizë për punë kërkues për periudhë më pak se tre muaj

Është kusht që të mos jetoni në Norvegji ndërsa aplikoni për azil apo nëse jeni në pritje për t'u larguar nga vendi pas një aplikimi të dështuar për azil.

Aplikimet e bëra nga Norvegjia duhet të paraqiten në policinë e distriktit ku jetoni.

Disa grupe të aplikantëve për leje studimi janë të përjashtuar nga kërkesa që leja të jepet përpara hyrjes së tyre në Norvegji. Mund të aplikoni nga Norvegjia nëse:

- Hyni nën kujdesin e Shërbimit Amerikan në Terren (AFS), Shkëmbimit të Studentëve Skandinavë Amerikanë (ASSE), Fulbright, Të Rinjtë për të Kuptuar (YFU), STS Fondacionit të Shkollës së Lartë (STS), Këshillit Kërkimor të Norvegjisë (NFR)
- Keni një bursë nga Agjencia Norvegjeze e Bashkëpunimit për Zhvillim (NORAD) ose institucion tjetër publik norvegjez
- Do të studioni në një institucion të arsimit të lartë brenda kuadrit të një skeme shkëmbimi sipas një marrëveshjeje dypalëshe ndërmjet një institucioni norvegjez dhe të huaj të arsimit të lartë në vendin tuaj.

Megjithatë, rekomandohet aplikimi nga vendi juaj i origjinës, sepse policia shpesh kërkon shumë kohë për shqyrtimin e çështjeve. Nëse ju kërkohet vizë dhe aplikoni nga Norvegjia, do të paguani një detyrim shtesë, pasi do të paguani tarifën e aplikimit për vizë dhe një tarifë për aplikimin për leje qëndrimi me qëllim arsimim.

Cfarë duhet të përmbajë aplikimi?

Kur të aplikoni për një leje qëndrimi për qëllime arsimimi, duhet të përfshini dokumentet e mëposhtme:

- Formulari i aplikimit për studentë
- Fotografi pasaporte/fotografi tjetër që plotëson kërkesat e caktuara <http://www.udi.no/templates/Page.aspx?id=7423>
- Një letër pranimi nga institucioni arsimor ku dëshironi të studioni. Letra e pranimit duhet të përmbajë emrin tuaj, informacion për institucionin arsimor, studimet dhe nivelin ku jeni pranuar, si dhe kohëzgjatjen e studimeve
- Dokumentacion për strehimin
- Dokumentacion të mjeteve të jetesës (dokumentacion të mbështetjes nga Fondi Shtetëror i Huasë për Arsimim dhe/ose dokumentacion që shuma e kërkesës për mjete jetese të jetë depozituar në një llogari bankare norvegjeze në emrin e aplikantit ose në llogarinë e institucionit arsimor për këtë qëllim)
- Fotokopje e pasaportës
- Ju duhet të paguani një tarifë: <http://www.udi.no/templates/Page.aspx?id=7426>

Si rregull kryesor, është e mjaftueshme që fotokopje të dokumenteve të dërgohen me aplikimin. Megjithatë, duhet të paraqisni dokumente origjinale kur të dorëzoni aplikimin.

Të gjitha dokumentet e bashkëngjitura me aplikimin duhet të përkthehen në anglisht ose norvegjisht.

Studentë të programeve të shkëmbimit

Rregullat e përgjithshme për një leje qëndrimi për qëllim arsimimi vlejné gjithashtu për studentët e programeve të shkëmbimit. Megjithatë, nëse qëndrimi do të financohet nga fonde publike ose një grant nga vendi i origjinës, në aplikim duhet të përfshihet dhe ky dokumentacion. Duhet të përcaktohet qartë si do të sigurohen paratë, sa do të jetë shuma (e konvertuar me kursin e shkëmbimit përkatës) dhe sa para do të transferohen në Norvegji (duke përcaktuar nëse do të jetë shumë mujore apo një pagesë e vetme)

Sa kohë do të duhet për shqyrtimin e aplikimit tim?

Koha e shqyrtimit të dosjes ndryshon. Për të pasur një ide për kohën mesatare të shqyrtimit për llojet e ndryshme të lejeve, vizitoni www.udi.no/caseworkingtime, ose kontaktoni Shërbimin e Informacionit (OTS) me e-mail (ots@udi.no) ose telefononi (+ 47) 23 35 16 00.

Jeni të lutur të mundësoni shumë kohë për aplikimin e tyre. Për të shmangur vonesa të panevojshme të shqyrtimit të dosjes, është e rëndësishme të bëni kujdes në plotësimin e formularit të aplikimit dhe të përfshini të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Të drejtat e mbajtësit të lejes

- Leja e qëndrimit jepet për të gjithë kohën e kursit të studimit
- Leja e qëndrimit e lëshuar për herë të parë e lejon studentin të punojë me kohë të pjesshme deri në 20 orë në javë dhe me kohë të plotë në ditë pushimi. Lexoni më shumë për rregullat e punës me kohë të pjesshme për studentët: <http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=7381>
- Leja nuk përbën arsye për një leje vendosjeje
- Anëtarë të familjes mund të vijnë në Norvegji sipas rregullave për imigracionin familjar (shih seksioni 7 më poshtë). Aplikimi i familjes do të shqyrtohet në të njëjtën njësi si aplikimi për personin kryesor.

A mund të shtyhet apo rinovohet leja?

Leja e qëndrimit për qëllime studimi mund të rinovohet. Një aplikim për rinovim mund të paraqitet të paktën një muaj përpara mbarimit të afatit të lejes aktuale. Aplikimi duhet të paraqitet në policinë e distriktit ku jetoni. Policia mund të miratojë aplikimin nëse është e qartë që janë plotësuar kushtet. Kur aplikoni për rinovim duhet të paguani gjithashtu një tarifë.

Për rinovim, duhet të siguroni konfirmim të financimit e në llogarinë bankare norvegjeze (deklarata bankare) që nga data 1 e çdo muaji, për gjashtë muajt e fundit.

Kur të aplikoni për rinovim duhet të paraqisni dokumentacionin e mëposhtëm:

- një raport nga ofruesi i arsimit me detaje për ecurinë tuaj studimore
- një deklaratë nga ofruesi i arsimit që të qartësojë nëse puna me kohë të pjesshme do të jetë pengesë apo jo për ecurinë tuaj në studime dhe sa orë mendohet se ju mund të punoni
- dokumentacion i mjeteve të jetesës (njësoj si për lejen e qëndrimit për herë të parë)
- nëse do të bëni punë në terren, duhet të përcaktohet kohëzgjatja. Autoritetet e migracionit nuk japin leje për periudhën e punës në terren nëse kohëzgjatja është më shumë se gjashtë muaj. Leja në këtë rast do të jetë e vlefshme deri në momentin e nisjes. Do të duhet të paraqisni një aplikim të ri (nga jashtë) kur të ktheheni në Norvegji për të përfunduar studimet.

A mund të ankohe kundër një vendimi?

Nëse aplikimi juaj për leje qëndrimi refuzohet, mund të ankoheni kundër këtij vendimi. Nëse ankoheni, aplikimi do të ri-shqyrtohet nga Drejtoria Norvegjeze e Imigracionit (UDI). UDI mund të përmbysë këtë vendim dhe t'ju japë lejen e kërkuar. Nëse UDI lë në fuqi vendimin, çështja i dërgohet Bordit të Ankesave për Imigracionin (UNE) për t'u shqyrtuar sërish.

Pyetje të tjera?

Për më shumë informacion, shihni qarkoren e UDI-t për studentët: <http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=7417> . Nëse akoma nuk jeni të qartë për çdo gjë që lidhet me mënyrën e aplikimit për leje qëndrimi, mund të kontaktoni ambasadën apo konsullatën norvegjeze më të afërt, ose Shërbimin e Informacionit (OTS): <http://www.udi.no/templates/Page.aspx?id=7471> .

Bursa universitare dhe pasuniversitare

Në Institucionet arsimore të arsimit të lartë në Norvegji nuk ka tarifa mësimore edhe pse shumica kërkojnë pagesën e një tarife të vogël për regjistrimin semestral. Kostoja e granteve të jetesës i jepet vetëm

studentëve ndërkombëtarë të pranuar në programet e përzgjedhura të bursave. Studentët me vetëfinancim duhet të dokumentojnë që kanë minimumi 80 000 NOK (përafërsisht 10.000 euro) për një vit akademik.

Shtetasit e huaj të mëposhtëm janë të pranueshëm për hua dhe pagë për studentë nga Fondi Shtetëror i Huasë për Arsimim:

- (shtetasit nordikë)
- (shtetasit e vendeve të ZEE)
- Shtetasit e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore si dhe të vendeve në zhvillim
- Refugjatët politikë dhe personat që kanë marrë leje qëndrimi për arsye humanitare
- Imigrantët

Ndihmë financiare për studentët e huaj

Mbështetja financiare nga Fondi Shtetëror i Huasë për Arsimim (Lånekassen), kryesisht orientohet për shtetasit norvegjezë, megjithatë, disa shtetas të huaj mund të pranohen për këtë mbështetje.

Nëse jeni shtetas i huaj, e drejta juaj për mbështetje financiare nga Lånekassen varet nga lidhja juaj me Norvegjinë, vendi prej të cilit vini dhe arsyet për të cilat keni leje qëndrimi.

Lexoni më shumë për të ditur kush mund të pranohet në:
http://www.lanekassen.no/templates/Page_5693.aspx

Për të aplikuar për mbështetje financiare nga Fondi Shtetëror i Huasë për Arsimim (Lånekassen) ju duhet një leje qëndrimi dhe konfirmimi i pranimit nga një institucion arsimor norvegjez.

Europa Qendrore dhe Lindore, Azia Qendrore dhe vendet në zhvillim:

Çdo vit, universitetet dhe kolegjet norvegjeze pranojnë një numër studentësh nga vendet në zhvillim dhe vendet në Europën Qendrore dhe Lindore dhe Azia Qendrore sipas skemave të veçanta të kuotave. Lexoni më shumë për Skemën e Kuotave http://www.lanekassen.no/templates/Page_10507.aspx

Refugjatët politikë apo azil kërkuesit:

Nëse keni ardhur në Norvegji si refugjat politik, mund të merrni mbështetje nëse

- keni statusin e refugjatit
- jeni azil kërkues dhe ju është dhënë leje qëndrimi për arsye humanitare
- keni ardhur në Norvegji në lidhje me bashkimin familjar me një refugjat të regjistruar dhe ju është dhënë azil politik

Kur aplikoni për mbështetje financiare, ju lutemi bashkëngjisni letrën nga UDI (Drejtoria e Imigracionit) që përcakton arsyet për të cilat ju është dhënë një leje qëndrimi. Duhet të bashkëngjisni gjithashtu një fotokopje të lejes së vlefshme të qëndrimit.

Granti i refugjatit

Ju mund të kualifikoheni për grantin e refugjatit nëse keni arsim të mesëm dhe keni statusin e refugjatit. Nuk kualifikoheni për grantin e refugjatit nëse keni leje qëndrimi për arsye humanitare.

Imigrantët

Si imigrant mund të pranoheni për mbështetje financiare nëse plotësoni një prej kriterëve të mëposhtme:

- Keni punuar me kohë të plotë, pa ndërprerje në Norvegji të paktën 24 muaj menjëherë përpara se të bëheshit student dhe keni paguar taksat norvegjeze gjatë kësaj periudhe

- Keni studiuar në Norvegji me kohë të plotë gjatë tre viteve të shkuara pa mbështetje nga Lånekassen dhe keni kaluar të gjitha provimet. Nëse keni studiuar me kohë të pjesshme, arsimimi i plotë duhet të jetë ekuivalent me tre vjet arsimim me kohë të plotë
- Jeni i martuar ose jeni partner i regjistruar me një shtetas norvegjez dhe të dy jetoni në Norvegji
- Ju është dhënë leje pune ose qëndrimi për bashkim familjar me një shtetas norvegjez ose të huaj ose ju është dhënë leje vendosjeje për shkak të kësaj leje
- Ju është dhënë leje qëndrimi si pasardhës i një shtetasi norvegjez që ka emigruar në Gadishullin Kola

Çfarë është mbështetja financiare nga Lånekassen?

Mbështetja nga Lånekassen përmban një hua dhe një grant që do të mbulojë koston e studimit në Norvegji. Do t'ju duhet vetëm të ri-paguani huanë. Nëse keni fëmijë me leje qëndrimi që jetojnë së bashku me ju në Norvegji mund të merrni më shumë mbështetje. Nëse punoni ndërsa jeni student, mbështetja financiare do të reduktohet.

Që të aplikoni për mbështetje financiare duhet të jeni **pranuar** në një institucion arsimor norvegjez dhe ju duhet një leje qëndrimi përpara se të paguhet mbështetja financiare.

Lista e universiteteve dhe kolegjeve kryesore

- Kolegji Agder: <http://www.uia.no/en>
- Universiteti Bujqwsor i Norvegjisw (NLH) <http://www.umb.no/index.php?avd=30>
- Kolegji Ålesund: <http://wwwold.hials.no/index.php?lang=eng>
- Kolegji Bergen: <http://www.hib.no/english/index.html>
- Universiteti Bergen: <http://www.uib.no/info/english/>
- Kolegji Gjøvik: <http://english.hig.no/>
- Høgskolen i Bodø: <http://www.hibo.no/index.php?lang=eng>
- Høgskolen i Hedmark: <http://english.hihm.no/>
- Høgskolen i Oslo: <http://www.hio.no/content/view/full/4563>
- Kolegji Lillehammer: http://www.hil.no/hil/lillehammer_university_college
- Kolegji Molde: <http://www.himolde.no/english>
- Kolegji Kombwtar i Artit dhe Dizajnit Norvegji: <http://www.ncad.ie/faculties/visualculture/research/thoughtlines/nryan.shtml>
- Kolegji Nesna: <http://interskola2007.hinesna.no/>
- Kolegji Nord-Trøndelag: <http://www.hint.no/hint/international>
- Instituti Norvegjez i Teknologjisë, Trondheim: <http://www.ntnu.no/english/>
- Shkolla Norvegjeze e Ekonomisë dhe Menaxhimit të Biznesit: <http://www.nhh.no/Default.aspx?AreaID=7>
- Shkolla Norvegjeze e Menaxhimit: http://www.bi.no/Content/StartPageEnglish_56401.aspx
- Kolegji Oppland: http://www.hil.no/hil/lillehammer_university_college
- Kolegji Østfold: <http://www.hiof.no/index.php?ID=3&lang=eng>
- Kolegji Sør-Trøndelag (HiST): <http://www.hist.no/english/>
- Kolegji Stavanger: <http://www.hsr.no/>
- Kolegji Stord/Haugesund: <http://www.hsh.no/english.htm>
- Kolegji Telemark: <http://www.hit.no/english>
- UNIK – Qendra për Teknologji nw Kjeller, Universiteti i Oslos: <http://www.unik.no/Default.asp?>
- Universiteti i Oslos: <http://www.uio.no/english/>
- Universiteti i Tromsø: <http://uit.no/informasjon/english?Language=en>
- Kolegji Vestfold: <http://www.hive.no/engelsk/>
- Kolegji Volda: <http://www.hivolda.no/index.php?lang=eng>

Programe për studentët e huaj

Sistemi norvegjez për arsimin e lartë është pjesë e një rrjeti me institucione në vendet nordike, Bashkimin Europian, shtetet Balltike dhe Europën Lindore dhe ka një traditë të gjatë bashkëpunimi me institucionet në vendet në zhvillim. Politikat në lidhje me studentët ndërkombëtarë i japin përparësi solidaritetit dhe pjesëmarrjes në zhvillimin global.

Institucionet norvegjeze të arsimit të lartë mirëpresin aplikime nga studentë të kualifikuar nga e gjithë bota. Mbi 9000 shtetas të huaj janë të regjistruar aktualisht në këtë nivel të sistemit arsimor. Studentët ndërkombëtarë mund të aplikojnë për t'u pranuar në një larmi programesh parauniversitare dhe universitare. Disa universitete dhe kolegje ofrojnë programe të hartuara specifikisht për studentë të huaj. Këto programe zhvillohen në anglisht dhe pranimi në to nuk kërkon qëndrim të përhershëm.

Studentë ndërkombëtarë janë përkufizuar të gjithë studentët që nuk kanë leje të përhershme qëndrimi në Norvegji. Ekzistojnë tre kategori të studentëve ndërkombëtarë: studentët e vetëfinancuar, studentët e programeve të shkëmbimit dhe studentët që marrin pjesë në programe të ndryshme bursash. Pranueshmëria në programe shkëmbimi dhe bursa zakonisht përcaktohet në bazë të marrëveshjeve kombëtare dhe dypalëshe rajonale dhe përmbushjes së kërkesave të kuotave. Pjesëmarrja në disa programe financimi është e kufizuar me numrin e aplikantëve nga vende specifike (Për më shumë informacion shih seksionin e mësipërm për bursat në lidhje me të huajt)

Kolegji Universitar Hedmark është një Kolegj Universitar me karakter ndërkombëtar dhe thekson shkëmbimin e studentëve dhe të stafit nëpërmjet programeve të bashkëpunimi europian dhe kombëtar dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit. Më shumë informacion në:

http://www.hihm.no/eway/default.aspx?pid=259&trg=Left_7773&Left_7773=9202:26360::0:8103:1::0:0

5. Qëndrimi

Si rregull, kushdo ka të drejtë të qëndrojë në Norvegji për tre muaj pa leje qëndrimi. Megjithatë, rregullat ndryshojnë për ata shtetas të huaj që kanë nevojë për vizë dhe për ata që nuk kanë nevojë për vizë.

Leje qëndrimi për shtetasit e huaj që kanë nevojë për vizë

Shtetasit e huaj që kanë nevojë për vizë duhet të aplikojnë për vizë me qëllim që të qëndrojnë në Norvegji/zonën Shengen. Viza mund të jepet deri në tre muaj, por kohëzgjatja e qëndrimit mund të kufizohet gjithashtu. Nëse dëshironi të qëndroni në Norvegji për më shumë se tre muaj duhet të aplikoni për leje qëndrimi. Nëse doni të punoni ndërsa jeni në Norvegji, duhet të aplikoni për leje pune. Ju lutemi, kini parasysh që përgjithësisht të aplikoni nga vendi i origjinës për lejet e qëndrimit dhe të punës.

Kush mund të aplikojë për leje qëndrimi?

Ekzistojnë lloje të ndryshme të lejeve të qëndrimit për kategori të ndryshme të punëtorëve, secila prej të cilave me kërkesa të ndryshme:

- ***Leje qëndrimi për studentë:*** Shih seksionin 3 më lart dhe <http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=7417>
- Shkolla të larta popullore: <http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=7419>
- ***Persona nën drejtimin e Këshillit Kërkimor të Norvegjisë:*** <http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=7422>
- ***Kërkuesit që financojnë qëndrimin e tyre me mjetet e tyre:*** <http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=7421>

Gjithashtu, një leje për dy vjet gjithsej mund t'i jepet:

- Muzikantëve performues, argëtuesve ose artistëve
- Personave të përfshirë në përhapjen e njohurive për Norvegjinë dhe kulturën norvegjeze jashtë
- Sportistëve dhe sportistëve

Qëndrimi deri në një vit mund të jepet gjithashtu për:

- Trajtim mjekësor dhe si shoqërues të nevojshëm

Për leje qëndrimi për shoqërim/ribashkim me familjen, shihni rregullat e veçanta për imigracionin familjar (Seksioni 7 më poshtë dhe <http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=4475>)

Si të aplikoj?

Për të aplikuar për një leje qëndrimi, duhet të plotësoni një formular aplikimi. Aplikimi duhet të paraqitet nga vendi juaj i origjinës ose një vend tjetër ku keni qenë rezident i ligjshëm për të paktën gjashtë muaj. Nuk mund të hyni në vend derisa t'ju jetë dhënë leja. Aplikimi duhet të paraqitet në misionin norvegjez të shërbimit të huaj më të afërt (ambasadë, konsullatë e përgjithshme). Gjithashtu duhet të informoheni për vendimin në lidhje me aplikimin nëpërmjet misionit të huaj të shërbimit.

Megjithatë, disa persona mund të aplikojnë për leje qëndrimi nga Norvegjia. Kjo vlen për ata që cilësohen si punëtorë të kualifikuar/specialistë dhe ose:

- kanë një leje qëndrimi ose pune që zgjat tre muaj ose më shumë
- kanë marrë një vizë për tre muaj
- kanë të drejtë të jetojnë në Norvegji për tre muaj pa leje (pra pa kërkesë për vizë) ose
- ju është dhënë një vizë, pra një vizë për punë kërkues për periudhë më pak se tre muaj

Aplikimet nga Norvegjia duhet të dorëzohen në policinë e distriktit ku jetoni.

Është kusht gjithashtu që ndërsa aplikoni për azil të mos jetoni në Norvegji ose ndërsa prisni të largoheni nga vendi pas një aplikimi të dështuar për azil.

Cfarë duhet të përmbajë aplikimi?

Përveç një formulari aplikimi të plotësuar ju duhet të përfshini:

- Fotokopje të pasaportës (të gjitha faqet e plotësuara)
- Fotografi pasaporte/fotografi tjetër që plotëson kërkesat e caktuara
- Duhet të paguani tarifën gjithashtu

Dokumentacioni i kërkuar përveç listës së mësipërme varion në varësi të llojit të lejes për të cilën aplikoni. Prandaj duhet të lexoni informacionin për lejen specifike.

Shënim: Kërkesa për dokumentacion ndryshon nga një vend në tjetrin dhe mund të ndryshojë me kalimin e kohës. Prandaj duhet të kontrolloni cilat kërkesa janë të vlefshme duke kontaktuar ambasadën norvegjeze në vendin prej të cilit po aplikoni.

A mund të aplikoj për leje për të punuar me kohë të pjesshme?

Për të marrë një leje për të punuar me kohë të pjesshme, duhet

- Të keni një leje qëndrimi
- Të keni një ofertë konkrete punësimi në formën e një kontrate punësimi
- Të keni paguar tarifën: <http://www.udi.no/templates/Page.aspx?id=7426>

Nuk ka kërkesa në lidhje me llojin e punës ose pagës. Orët e punës duhet të arrijnë jo më shumë se 50% të një pune me kohë të plotë, deri në maksimumi 20 orë në javë. Gjatë pushimeve standarde, mund të jepet leje për punë me kohë të plotë.

Aplikimi duhet të dorëzohet në policinë e distriktit ku jetoni. Mund të aplikoni ose në të njëjtën kohë si për aplikimin për lejen e qëndrimit ose në një formular të veçantë (GP-7115B) sapo të jetë dhënë leja e qëndrimit.

Leja lidhet me një punë të caktuar dhe një vend të caktuar pune. Prandaj, nuk mund të filloni ndonjë punë tjetër pa aplikuar më përpara për një leje të re pune.

Një leje pune me kohë të pjesshme mund të rinovohet në lidhje me rinovimin e lejes së qëndrimit.

* Një përcaktim i i saktë i kushteve të lejes mund të gjendet në seksionin 17 të Rregullave të Imigracionit: <http://www.zu.ac.ae/library/html/UAEInfo/documents/UAEImmigrationLaw.pdf>

Sa kohë do të duhet që të shqyrtohet aplikimi im?

Koha e shqyrtimit të dosjes ndryshon. Për të patur një ide për kohën mesatare të shqyrtimit për llojet e ndryshme të lejeve, vizitoni www.udi.no/caseprocessingtime, ose kontaktoni Shërbimin e Informacionit (OTS) me e-mail (ots@udi.no) ose telefononi (+ 47) 23 35 16 00.

Jeni të lutur të mundësoni shumë kohë për aplikimin e tyre. Për të shmangur vonesa të panevojshme të shqyrtimit të dosjes, është e rëndësishme të bëni kujdes në plotësimin e formularit të aplikimit dhe të përfshini të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

A mund të ankohem kundër një vendimi?

Nëse aplikimi juaj për leje qëndrimi refuzohet, mund të ankoheni kundër këtij vendimi. Nëse ankoheni, aplikimi do të ri-shqyrtohet nga Drejtoria Norvegjeze e Imigracionit (UDI). UDI mund të përmbysë këtë vendim dhe t'ju japë lejen e kërkuar. Nëse UDI lë në fuqi vendimin, çështja i dërgohet Bordit të Ankesave për Imigracionin (UNE) për t'u shqyrtuar sërish.

Pyetje të tjera?

Për më shumë informacion, shihni qarkoren e UDI-t për studentët: <http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=7417> . Nëse akoma nuk jeni të qartë për çdo gjë që lidhet me mënyrën e aplikimit për leje qëndrimi, mund të kontaktoni ambasadën apo konsullatën norvegjeze më të afërt, ose Shërbimin e Informacionit (OTS): <http://www.udi.no/templates/Page.aspx?id=7471> .

6. Azili

<http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=7545>

Procedura në rastet e azilit

Përpunimi i një aplikimi për azil mund të zgjasë nga 48 orë në disa muaj. Më poshtë do të gjeni informacion për procedurën në rastet e azilit.

Kur mbërrini në Norvegji:

Pas regjistrimit në polici, akomodoheni në një qendër pritjeje transit. Në qendër duhet të mbushni një deklaratë personale. Informacioni që jepni në këtë deklaratë do të jetë bazë për shqyrtimin e aplikimit tuaj për azil. Organizata Norvegjeze për Azilkërkuesit (NOAS) ndihmon të gjithë azilkërkuesit në fazën e aplikimit duke dhënë informacion se çdo do thotë azilkërkues, mundësitë për të fituar azilin, kuadrin rregullues të Dublinit dhe faktorë të tjerë që ju prekin ju si azilkërkues.

1. Intervista

Brenda një periudhë të shkurtër UDI do t'ju thërrasë për një intervistë. UDI do të sigurojë një përkthyes nëse ju nevojitet gjatë intervistës. Përkthyesi do të komunikojë në mënyrë të saktë atë që thuhet. Përkthyesi ka për detyrë të ruajë fshehtësinë, edhe pas mbarimit të intervistës. Përdorimi i një përkthyesi nuk ju kushton juve aspak.

Do të pyeteni për:

- veten, familjen tuaj dhe vendin tuaj të origjinës
- arsyen pse u larguat nga vendi i origjinës
- rrugën që ndoqët
- arsyen pse po aplikoni për azil tani

Intervista do të zhvillohet në ambientet e UDI-t ose në qendrën e pritjes transit. Nëse jeni nën 18 vjeç, do t'ju caktohet një kujdestar i përkohshëm. Një kujdestar i përkohshëm është një person i rritur i caktuar nga shteti për t'ju ndihmuar. Më shumë informacion për fëmijët dhe të rinjtë në çështjet e azilit gjendet në <http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=7582>

Informacioni që do të jepni do të shkruhet. Është e rëndësishme për shqyrtimin e aplikimit tuaj për azil që përgjigjet që jepni të jenë sa më të sakta dhe të plota të mundshme. Duhet t'i thoni intervistuesit gjithçka që mund të jetë e rëndësishme për aplikimin tuaj, edhe nëse nuk ju bëhet një pyetje e drejtpërdrejtë për atë. Nëse keni dokumente për ndonjë informacion që jepni, duhet t'i dorëzoni.

Zbardhja e intervistës do t'ju lexohet. Duhet të kontrolloni që është shkruar saktë. Dhënia e informacionit të rreme është akt kriminal. Nëse jepni informacion që nuk është i vërtetë, autoritetet mund të dyshojnë për informacionin tjetër që keni dhënë. Nëse zbulohet që keni marrë leje qëndrimi në bazë të informacionit të rreme, leja do të tërhiqet.

2. Shqyrtimi i aplikimit

Për të gjitha llojet e aplikimeve, qëllimi është që të arrihet një vendim shpejt sapo të jetë siguruar informacioni i nevojshëm. Procedura për shqyrtimin e aplikimeve për azil ndryshon në varësi të llojit të rastit.

Procedurat e ndryshme për shqyrtim janë:

2.1. Procedura 48- orëshe

Të gjithë azilkërkuesit aplikimet e të cilëve supozohen të jenë të pabazuara mblidhen në një qendër transit pritjeje në zonën e Oslos. Policia kontrollon rrugën e ndjekur, ndërsa UDI bën intervista për të qartësuar arsyet për azil. Intervista bëhet në Christian Kroghs gt. Nuk keni nevojë të shkruani një deklaratë personale. Nëse çështja është dukshëm e pabazuar, do të refuzohet brenda 48 orëve dhe do të transportoheni jashtë Norvegjisë.

Nëse çështja juaj nuk trajtohet sipas procedurës 48-orëshe, do të dërgoheni në qendrën transit të pritjes në zonën e Oslos. Do të jetoni atje derisa UDI t'ju intervistojë.

2.2. Procedura sipas Konventës së Dublinit

Nëse çështja juaj është sipas Konventës së Dublinit, përgjegjësia bie mbi vendin tuaj ku aplikuat fillimisht për azil ose ku ju është dhënë një leje qëndrimi/viza Shengen. Nuk do të intervistoheni nga UDI. Përgjigjet juaj bëhet nëse jeni azilkërkues i mitur i pashoqëruar.

2.3. Procedura për të mitur të pashoqëruar

Nëse jeni nën 18 vjeç dhe keni ardhur në Norvegji pa prindër apo dikë tjetër që ka mbi ju përgjegjësi prindërore, konsideroheni azilkërkues i mitur i pashoqëruar dhe për ju do të caktohet një kujdestar.

Në këto raste, intervista e zakonshme zhvillohet me praninë e kujdestarit. Nëse pretendoni se jeni nën 18 vjeç, por dukeni më i madh, mund të kryhet një test për moshën. Ky është test vullnetar dhe duhet miratimi juaj për të kryer testin.

Lexoni më shumë për testin e moshës: <http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=7583>

2.4. Procedura tre-javore

Në raste kur qëllimi është shqyrtimi i aplikimit tuaj në tre javë (procedura tre-javore), zhvillohen intervistat e zakonshme të azilit. Pas intervistës, aplikanti dërgohet në qendrën e pritjes ndërsa shqyrtohet çështja. Aplikimet nga vende prej nga përvoja ka treguar që refuzohen shumë raste dhe për të cilat UDI është në dijeni për situatën në vend, shqyrtimi bëhet sipas procedurës tre-javore.

UDI do të marrë një vendim tre javë pas paraqitjes së aplikimit tuaj për azil në Norvegji nëse nuk ka nevojë për hetime apo verifikime të mëtejshme të rastit të azilit. Vende që aktualisht trajtohen sipas procedurës tre-javore janë: **Shqipëria, Bjellorusia, Bosnja dhe Hercegovina, Gjeorgjia, Maqedonia, Rusia (me përjashtim të Çeçenisë) Serbia (me përjashtim të pakicave nga Kosova) dhe Mali i Zi.**

Nëse nuk jeni nga një prej këtyre vendeve, mund të duhen disa muaj që të shqyrtohet aplikimi juaj. UDI akoma synon të arrijë një vendim sapo të jetë siguruar informacioni i nevojshëm. Koha e shqyrtimit në këto çështje mund të ndryshojë. Në çështje që kanë nevojë për më shumë informacion dhe verifikime, shqyrtimi mund të kërkojë disa muaj për t'u përfunduar. Duhet të kontribuoni për të siguruar sa më shumë informacion që të jetë e mundur, pasi kontributi juaj mund të reduktojë kohën e shqyrtimit të aplikimit tuaj.

Koha e shqyrtimit mund të jetë gjithashtu e gjatë për arsye të tjera siç janë numri më i madh i çështjeve për t'u shqyrtuar krahasuar me numrin e tyre që mund të shqyrtohen.

3. Vlerësimi i aplikimeve

Bazë për marrjen e një vendimi do të jenë:

- shpjegimi juaj i dhënë në intervistën për azil
- deklaratat juaj personale (kur është dhënë), verifikimet dhe testet e gjuhës
- çdo informacion i siguruar nga ju ose avokati juaj ndërsa çështja është në shqyrtim

UDI krahason shpjegimin tuaj me faktet për rrethanat në vendin tuaj të origjinës dhe informacion tjetër për situatën aktuale në vendin e origjinës. UDI përdor informacionin e siguruar, për shembull, nga misionet norvegjeze të shërbimit të huaj, vende të tjera, UNHCR, *Amnesty International*, organizata të tjera vullnetare dhe udhëtimet jashtë vendit.

4. Vendimet për aplikimet

Nëse merrni një përgjigje pozitive për aplikimin tuaj, mund t'ju jepet azili ose një leje qëndrimi bazuar në arsye humanitare. Në këtë rast do të njoftoheni nga policia. Nëse merrni një përgjigje negative, rezultati është refuzim dhe do të njoftoheni nga një avokat i caktuar për t'ju ndihmuar.

Azili

Nëse aplikimi juaj është i suksesshëm, do t'ju jepet leje pune dhe/ose qëndrimi në Norvegji si refugjat. Do të merrni një dokument udhëtimi për refugjat në vend të pasaportës. Ky dokument udhëtimi nuk është i vlefshëm për udhëtime në vendin tuaj të origjinës.

Qëndrimi për arsye humanitare

Nëse nuk ju jepet azil, autoritetet norvegjeze do të vlerësojnë automatikisht nëse pavarësisht nga kjo mund t'ju jepet një leje qëndrimi për arsye mbrojtjeje ose për arsye humanitare. Në këto raste duhet të ketë arsye të fuqishme humanitare. Nëse ju jepet leje qëndrimi për arsye humanitare, normalisht do t'ju nxirret një pasaportë imigranti.

Refuzimi

Nëse autoritetet norvegjeze refuzojnë aplikimin tuaj për azil dhe nuk ka arsye për t'ju dhënë një leje qëndrimi bazuar në arsye për mbrojtje apo humanitare, duhet të largoheni nga vendi. Mund të ankoheni kundër vendimit. Ankesa i dërgohet UDI-t.

E drejta e ankimit

Nëse UDI refuzon aplikimin tuaj për azil, keni të drejtë të ankoheni dhe një avokat do të caktohet për t'ju ndihmuar. Ankesa i dërgohet UDI-t. Nëse UDI nuk e ndryshon vendimin, ankesa i dërgohet Bordit të Ankesave për Imigracionin (UNE).

Ankesa juaj duhet të përfshijë detaje për:

- vendimin kundër të cilit po ankoheni
- kohën kur u njoftuat për vendimin
- çfarë dëshironi të ndryshojë në vendim
- arsyet që doni këtë ndryshim
- informacion të ri që mund të ketë ndikim në rezultat

Nëse ankoheni kundër refuzimit të aplikimit tuaj për azil, normalisht do të mund të qëndroni në Norvegji gjatë shqyrtimit të ankesës. Nëse UDI konsideron që aplikimi juaj është padyshim i pabazuar, mund të urdhëroheni megjithatë të largoheni nga Norvegjia përpara shqyrtimit të ankesës.

Avokati caktohet për t'ju ndihmuar dhe ai do të shërbejë si hallkë ndërmjet jush dhe autoriteteve norvegjeze. Avokati juaj për shembull duhet të mbajë shënim afatet kohore dhe të sigurohet që çështja juaj e ankimit të shqyrtohet me korrektësi.

Afati për ankesat

Duhet të ankoheni tre javë brenda marrjes së vendimit. Ankesa juaj duhet të postohet përpara përfundimit të afatit. UDI mund të mos e konsiderojë ankesën nëse e dorëzoni shumë vonë. Mund të aplikoni për zgjatje të afatit për ankesat. Nëse e bëni këtë gjë, duhet të përcaktoni arsyen pse kërkon shtyrje të afatit. Nëse nuk keni arritur dot të plotësoni afatin për ankesat, mund të aplikoni që çështja juaj të rivendoset. Duhet të shpjegoni pse nuk dorëzuat ankesën përpara përfundimit të afatit. Procedura për dhënien e kësaj rivendosjeje është relativisht strikte.

Keni të drejtë të dini arsyet pse u mor vendimi. Nëse mendoni që UDI nuk ka justifikuar vendimin e tij, mund të kërkonit këtë justifikim përpara mbarimit të afatit për ankesa. Një afat i ri për ankesat do të llogaritet më pas nga data kur keni marrë justifikimin.

Skema e procedurës së çështjes: <http://www.udi.no/templates/Page.aspx?id=8351>

7. Bashkimi familjar

<http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=4475>

Imigracioni familjar bën të mundur që një anëtar i familjes jashtë vendit të vijë të jetojë në Norvegji me një anëtar të familjes që jeton tashmë në Norvegji, ose që do të vendoset atje.

Kushtet për bashkim familjar

Për të marrë një leje për imigracion familjar, duhen plotësuar disa kërkesa nga familjarët e huaj që aplikojnë për një leje dhe nga personi që Norvegji me të cilin aplikojnë për t'u bashkuar. Gjithashtu, personi që është vendosur në Norvegji duhet të jetë në gjendje të sigurojë mjete jetese dhe strehim për ata që aplikojnë për imigracion familjar.

Mund t'ju jepet një leje për imigracion familjar nëse jeni një nga familjarët e afërt të personit që jeton në Norvegji. Këtu "familjarët e afërt" janë përcaktuar:

- Bashkëshort/e ose partner/ i/e regjistruar mbi 18 vjeç, kur çifti jeton bashkë në Norvegji
- Bashkëjetues mbi 18 vjeç kur çifti ka jetuar bashkë për të paktën dy vitet e fundit dhe synojnë të vazhdojnë bashkëjetesën
- Fëmijë kur të dy prindërit janë ose do të bëhen rezidentë të ligjshëm në Norvegji
- Fëmijë që kanë vetëm një prind të vendosur në Norvegji. Është kusht që prindi që jeton në Norvegji të ketë përgjegjësi prindërore të vetme ose nëse përgjegjësia prindërore është e përbashkët, prindi tjetër duhet të japë miratimin e tij/saj
- Fëmijë të adoptuar me prindër adoptues në Norvegji kur miratimi i Drejtorisë Norvegjeze për Fëmijët, të rinjtë dhe çështje familjare është dhënë përpara hyrjes
- Prindër dhe motra e vëllezër nën 18 vjeç të një fëmije që është një refugjat i rivendosur ose që ka statusin e azilantit në Norvegji
- Mamaja ose babai i një fëmije norvegjez. Ai ose ajo duhet të jetojë përherë me fëmijën dhe të ketë përgjegjësi prindërore mbi fëmijën. Mamaja ose babai nuk duhet të ketë bashkëshort/e ose bashkëjetues kur ai ose ajo vjen në Norvegji.
- Mamaja ose babai që ka të drejta për një fëmijë që jeton në Norvegji me prindin tjetër. Një person duhet të ketë jetuar në Norvegji me një leje të vitit të kaluar.

Anëtarë të tjerë të familjes

Anëtarëve të tjerë të familjes mund t'ju jepet gjithashtu leje për imigracion familjar nëse plotësohen kushte më të detajuara. Mund të aplikoni për imigracion familjar nëse jeni:

- mbi 18 vjeç dhe synoni të hyni në një martesë apo partneritet të regjistruar në Norvegji
- një bashkëjetues që ka ose pret një fëmijë me personin që po aplikoni për imigracion familjar për t'u bashkuar
- një mama ose baba beqar mbi 60 vjeç pa bashkëshort/e, bashkëjetues/e ose të afërm paraardhës apo pasardhës në vendin e origjinës dhe për të cilin djali ose vajza në Norvegji ka përgjegjësi të veçantë
- një fëmijë nga mosha 18 deri në 21 vjeç pa bashkëshort/e ose bashkëjetues/e që ka pasur më përpara leje qëndrimi afatgjatë në Norvegji
- një fëmijë mbi 18 vjeç pa bashkëshort/e ose bashkëjetues/e, që është ose që mbetet në vendin e origjinës kur pjesa tjetër e familjes fiton qëndrimin në Norvegji, ose që për arsye shëndetësore është tërësisht i varur nga kujdesi personal i prindërve në Norvegji
- një fëmijë i gjetur, nëse personi që jeton në Norvegji ka ushtruar përgjegjësi prindërore për fëmijën në përputhje me ligjin e vendit të origjinës dhe fëmija është anëtar i vendosur i familjes. Familja birësuese duhet të miratohet nga autoritetet norvegjeze të mbrojtjes së fëmijës
- një vëlla ose motër gjaku nën 18 vjeç pa mama ose baba dhe pa ndonjë kujdestar tjetër në vendin e origjinës ose vendin e rezidencës

Prindërit gjithashtu mund të vizitojnë fëmijët e tyre në Norvegji deri në 9 muaj, ose të vazhdueshëm ose të veçantë <http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=8713>

Kjo është leje e përkohshme dhe është kusht që prindërit të kthehen në vendin e tyre të origjinës me mbarimin e afatit të lejes.

Mund të gjeni përcaktim të detajuar të kushteve që rregullojnë anëtarë të tjerë të familjes në seksionin 24 të Rregullave për Imigracionin.
<http://www.zu.ac.ae/library/html/UAEInfo/documents/UAEImmigrationLaw.pdf>

Përkufizimi i fëmijës

Fëmijë do të thotë një person nën 18 vjeç që nuk ka bashkëshort/e ose bashkëjetues/e

Bashkëshortët dhe partnerët

Partnerët e regjistruar kanë të njëjtin status si bashkëshortët. Kjo do të thotë që i gjithë informacioni për bashkëshortët vlen gjithashtu për partnerët e regjistruar.

Arsye të fuqishme humanitare

Nëse nuk jeni në ndonjërin prej kategorive të mësipërme ose nuk plotësoni të gjitha kushte, UDI do të vlerësojë gjithmonë nëse ka arsye të fuqishme humanitare që tregojnë se aplikimi juaj për imigracion familja duhet të miratohet.

Pyetje të tjera?

Nëse akoma nuk jeni i qartë se kush mund të aplikojë për imigracion familjar, mund të kontaktoni ambasadën apo konsullatën norvegjeze lokale ose Shërbimin e Informacionit (OTS)

8. Kujdesi shëndetësor

Sistemi shëndetësor

<http://europa.eu.int/eures/userSatisfaction.do?method=vote&satisfaction=1>

Kur jetoni dhe punoni në Norvegji do të regjistroheni tek *Norske Folketrygden* [Sigurimi Kombëtar Norvegjez], që mbulon gjithë popullsinë. Kjo siguron kujdes shëndetësor publik që financohet nga Shteti norvegjez dhe menaxhohet nga kontetë. Për vizita tek doktorët paguhet një tarifë. Qëndrimet në spital janë përgjithësisht pa pagesë.

Shërbimi shëndetësor norvegjez bazohet në një model të decentralizuar. Shteti formulon politika, kapacitetet dhe cilësitë nëpërmjet buxhetit dhe legjislacionit. Kontetë dhe bashkitë zyrtarisht janë përgjegjëse për planifikimin dhe drejtimin e shërbimit shëndetësor sipas ligjit dhe kuadrove buxhetore.

Bashkitë janë përgjegjëse për shërbimin e kujdesit parësor:

- Masa shëndetësore parandaluese. Shërbimi shëndetësor në shkolla, klinika, fizioterapitë, shërbimi i mamive, kontrollet e shtatzënisë dhe programet e vaksinimit
- Diagnostikim, trajtim dhe rehabilitim. Shërbimi ambulator, trajtim i përgjithshëm mjekësor, fizioterapi dhe trajtim gjatë sëmundjes
- Ndihmë infermierie brenda dhe jashtë institucioneve. Spitale private dhe infermier/e të distriktit

Kontetë janë përgjegjëse për shërbimin publik dentar. Grupet e mëposhtme janë të përfshira:

- Fëmijë dhe adoleshentë (nën 21 vjeç)
- Njerëz me zhvillim të metë mendor
- Të moshuar dhe persona me paaftësi me sëmundje kronike që qëndrojnë në institucione ose shtëpi kujdesi
- Pjesa tjetër e popullsisë përdor shërbimin dentar privat, për të cilin pacientët paguajnë vetë. Shërbimi shëndetësor profesional në Norvegji është organizuar në mënyra të ndryshme. Korporata të mëdha individuale kanë shërbimet e tyre shëndetësore profesionale dhe disa kompani ndajnë shërbimin e përbashkët. Një model i tretë përfshin vendet e punës që blejnë shërbime shëndetësore profesionale nga një dhomë konsulte private e një doktori. Farmacitë janë në pronësi private, por drejtojnë biznesin e tyre nën kontroll të rreptë publik.

Sistemi i doktorit personal

Ka doktorë të përgjithshëm që kanë kontakte me sektorin publik/bashkinë. Të gjithë shtetasit e regjistruar në *Folkeregister* [Zyrën e Regjistrat] kanë të drejtë për doktorin e tyre të përhershëm. Doktorin juaj i përhershëm duhet të caktojë menjëherë takim me ju sipas çmimeve të bëra publike. Kjo është një marrëveshje vullnetare. Nëse zgjidhni një doktor tjetër që nuk ka kontratë me bashkinë, kostot janë më të larta. Mund të ndryshoni doktorin e përhershëm deri në dy herë në vit. (Por për të takuar doktorin e ri, doktori që keni zgjedhur duhet të ketë vend për ju në regjistrat e tij) Një listë e doktorëve mund të gjendet në *Gule Sider* [Fletët e Verdha].

Shërbimet private shëndetësore

Disa spitale private dhe institucione shëndetësore janë ngritur për të plotësuar institucionet dhe shërbimet publike. Ka gjithashtu rregullime gjysmë-private ku- për shembull- fizioterapisë që funksionojnë privatisht kryejnë shërbime në emër të autoriteteve shëndetësore publike. Shërbimi i urgjencës, aksidenteve dhe urgjencave, ofron shërbim mjekësor në raste urgjence (aksidente ose sëmundje). Ky është shërbim që ofrohet nga bashkia.

Shërbimet shëndetësore

<http://www.norway.no/temaside/tema.asp?id=500>

Shihni gjithashtu: Shërbimi shëndetësor dentar, personat e paaftë fizikisht, tarifat, zgjedhja e lirë e spitalit, doktorë të përgjithshëm (GP), klinikat shëndetësore, sigurimet shëndetësore, mjekimi, kujdesi shëndetësor mendor, kujdesi shëndetësor bashkiak, kujdesi shëndetësor i specializuar, vaksinimet.

Keni të drejtë të zgjidhni ku të merrni trajtim mjekësor:

Zgjedhja e Lirë e Spitalit (*Fritt sykehusvalg Norge*) është shërbim që u ofron pacientëve, të afërme dhe personelit të klinikës informacion të përditësuar në lidhje me të drejtat e pacientëve, kohën e pritjes dhe informacion tjetër të rëndësishëm që gjendet në spitale në Norvegji. Shërbimi mund të kontaktohet direkt në telefon falas **(+47) 800 41 004**.

Autoritetet përgjegjëse

Drejtoria për Çështje Shëndetësore dhe Sociale

http://www.shdir.no/portal/page?_pageid=134,112387&_dad=portal&_schema=PORTAL&language=english

Qendra Vullnetare: <http://app.norway.no/styresmakter/kvaliste.asp?id=99999>

Bashkitë: <http://app.norway.no/styresmakter/kvaliste.asp?id=45691>

Autoritetet e shëndetit: <http://app.norway.no/styresmakter/kvaliste.asp?id=45724>

Zyra lokale NAV: <http://app.norway.no/styresmakter/kvaliste.asp?id=46121>

Zyrat- lokale- të Sigurimeve shoqërore: <http://app.norway.no/styresmakter/kvaliste.asp?id=45596>

Pyetja të shpeshta

A jam i autorizuar të punoj në sektorin shëndetësor norvegjez?
Çfarë kujdesi shëndetësor dentar publik mund të marr?
Si të gjej një doktor në Norvegji?
Çfarë tarifa duhet të paguaj për trajtim shëndetësor në Norvegji?
Kush ka të drejtë për trajtim shëndetësor falas?

Gjejini përgjigjet në: <http://www.norway.no/oss/#a3170>

9. Sistemi i sigurimeve shoqërore

Skemat kryesore të përgjithshme të sigurimeve shoqërore në Norvegji janë Skema Kombëtare e Sigurimeve, Skema e Ndihmës Ekonomike dhe Skema e Përfitimit të të Hollave për familje me fëmijë të vegjël.

Për të mësuar më shumë shihni broshurën "Skema norvegjeze për sigurimet shoqërore" (shkarko) http://www.regjeringen.no/upload/AID/publikasjoner/veiledninger_og_brosjyrer/2008/dnts_eng.pdf

Broshura është prezantuar në faqen e Ministrisë së Punës dhe Përfshirjes Sociale dhe jep informacion për temat e mëposhtme:

Politika e tregut të punës: <http://www.regjeringen.no/en/dep/aid/Topics/Labour-market-policy.html?id=935>

Politika e të ardhurave: <http://www.regjeringen.no/en/dep/aid/Topics/income-policy.html?id=86948>

Mjedisi i punës dhe siguria në punë: <http://www.regjeringen.no/en/dep/aid/Topics/The-working-environment-and-safety.html?id=936>

Politika e të ardhurave: <http://www.regjeringen.no/en/dep/aid/Topics/income-policy.html?id=86948>

Migracioni: <http://www.regjeringen.no/en/dep/aid/Topics/Immigration.html?id=1134>

Integrim dhe larmi: <http://www.regjeringen.no/en/dep/aid/Topics/Integration-and-diversity.html?id=1138>

Programi prezantues dhe udhëzime në gjuhën norvegjeze për imigrantët e sapo ardhur: <http://www.regjeringen.no/en/dep/aid/Topics/andre/introductory-programme-and-norwegian-lan.html?id=1141>

Pakicat kombëtare: <http://www.regjeringen.no/en/dep/aid/Topics/National-minorities.html?id=1404>

Pensionet <http://www.regjeringen.no/en/dep/aid/Topics/pensions.html?id=939>

Politikat e popullit Sami <http://www.regjeringen.no/en/dep/aid/Topics/Sami-policy.html?id=1403>

Politikat e mirëqenies sociale <http://www.regjeringen.no/en/dep/aid/Topics/Welfare-policy.html?id=942>

Personat me paaftësi <http://www.regjeringen.no/en/dep/bld/Topics/Disabled-people.html?id=987>

10. Strehimi

http://www.cecodhas.org/index.php?option=com_content&task=view&id=84&Itemid=126

Qëllimi kryesor i politikave të strehimit në Norvegji është të sigurojë për të gjithë strehim të mirë dhe me çmim të përballueshëm dhe një mjedis të qëndrueshëm strehimi. Qëllimi kryesor i politikave të strehimit nuk ka ndryshuar në 50 vitet e fundit, por mjetet për të arritur qëllimin janë shumë të ndryshme sot krahasuar me të shkuarën. Ndërsa në të shkuarën këto mjete ishin rregulla publike dhe subvencione publike për të gjithë, sot i lihet tregut të vendosë. Mbështetja publike i jepet vetëm më të varfërve dhe atyre që janë më pak në gjendje për të siguruar për një shtëpi të denjë për veten. Në qytetet kryesore, kërkesa për shtëpi dhe çmimet janë të larta. Familje me të ardhura të vogla dhe të rinjtë nuk mund të përballojnë blerjen e një apartamenti, ndërsa situata mund të jetë shumë ndryshe në rajone të tjera me më pak presion. Gjatë 11-12 viteve të fundit çmimet janë rritur menjëherë dhe kjo tendencë ka vazhduar prej kohësh.

Kriteret e pranimit

Nuk ka kritere të veçanta pranimi të familjeve në ndonjë lloj strehimi në Norvegji. Autoritetet vendore janë përgjegjëse për të siguruar strehim të përshtatshëm për ata që nuk janë në gjendje të sigurojnë për veten. Siç përmendet më lart, në Norvegji është një sektor i vogël publik për qiradhënien. Një pjesë e këtyre banesave publike të qiradhënies nuk janë aspak strehim social, por vetëm një instrument për të tërhequr personel të kualifikuar të llojit të ndryshëm të nevojshëm në shërbime publike. Rendi sipas të cilit jepet strehimi publik me qira bëhet sipas një listë pritjeje. Kooperativat e strehimit dhe shoqatat bashkëpunuese për strehimin kanë qenë tradicionalisht një partner për autoritetet vendore në sigurimin e strehimit social. Autoritetet lokale kanë të drejtë të blejnë 10% të banesave në projekte të reja ndërtimi të shoqatave bashkëpunuese për strehimin. Në shumë raste, shoqatat bashkëpunuese të strehimit veprojnë, në emër të autoriteteve lokale, si zhvillues dhe menaxherë të strehimit me shërbimet e kujdesit dhe shëndetit dhe çdo lloj tjetër strehimi për personat me nevoja të veçanta.

Organizatat e përfshira në strehimin social

Bashkitë janë përgjegjëse për strehimin social. Qeveria, nëpërmjet Bankës Shtetërore për Strehimin, siguron mjetet financiare. Federata Norvegjeze e Shoqatave Bashkëpunuese për Strehim (NBBL) është organizata kryesore e përfshirë në strehimin social. Qëllimi i shoqatave bashkëpunuese për strehimin është të sigurojnë banesa të mira për anëtarët e tyre, por në përputhje me parimet bashkëpunuese kanë marrë dhe një përgjegjësi të madhe si partnerë për autoritetet lokale në strehimin social.

E drejta për strehim

Në kushtetutë nuk përmendet e drejta për strehim. Partitë politike të gjitha bien dakord dhe kanë qëllim të përbashkët për politikën e strehimit. Ky qëllim është që të gjithë kanë të drejtë për shtëpi të denjë dhe një mjedis të qëndrueshëm jetese. Vetëm në Ligjin Social ka dy dispozita që trajtojnë të drejtën e strehimit. E para trajton përgjegjësinë e autoriteteve vendore për të siguruar strehim për grupet e personave që janë në situatë të vështirë. Tjetra trajton detyrën e autoriteteve vendore për të siguruar për njerëzit në nevojë shtëpi të përkohshme.

Faqe interneti

http://www.alloexpat.com/moving_to_norway_forum/housing-in-norway-t169.html

11. Njohja e diplomave

Kërkesat për vlerësimin dhe njohjen e kualifikimeve

<http://www.hio.no/layout/set/print/content/view/full/59893>

Arsimimi i huaj që të njihet si ekuivalent me diplomën/arsimimin universitar/të kolegjit universitar duhet të plotësojë disa kushte:

- Arsimimi duhet të jetë regjistruar ose akredituar zyrtarisht si arsimim i lartë (nivel universitar/kolegj universitar) në vendin e origjinës dhe vetë institucioni duhet të jetë i regjistruar ose akredituar zyrtarisht
- Arsimi mund të jetë në të njëjtin nivel si arsimi i lartë norvegjez pra në nivel mbi kërkesat e përgjithshme minimale për pranim në universitete dhe kolegje universitare në Norvegji ("*generell studiekompentanse*"). Ndryshime thelbësore ndërmjet sisteme arsimore në Norvegji dhe vendit që ofron arsimim mund të rezultojnë vetëm në disa komponentë të caktuar të arsimit universitar/kolegjit universitar të huaj që njihet si ekuivalent me arsimin e lartë norvegjez. E ashtuquajtura **lista GSU** është hartuar për të shërbyer si guidë nëse kualifikimet e huaja do të njihen plotësisht apo jo. Siç tregon lista, aplikantët me arsim nga disa vende në Afrikë, Azi, Amerikë Qendrore dhe Jugore, vendet e ish Bashkimit Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet të kenë përfunduar një ose dy vjet arsim universitar përveç shkollës së mesme për të plotësuar

kërkesat minimale për pranim. Arsimi universitar nga këto vende që tejkalon një ose dy vitet në listën e GSU normalisht njihet sipas parimit të paritetit të kohës, ("*tid-for-tid-prinsippet*"), ju lutemi shihni më poshtë.

- Kolegji universitar i Oslos vetëm vlerëson dhe njeh arsimin e lartë të huaj brenda fushave të njëjta/korresponduese si diplomat dhe arsimi i ofruar nga OUC.
- Për t'u njohur sipas parimit të paritetit kohor, (studim nominal me kohë të plotë një vjeçare në vendin që ofron arsimin, është ekuivalent me studim një vjeçar me kohë të plotë në Norvegji /60 kredite) arsimimi i huaj duhet të ketë gjithë kreditet. Studimet me kohë të pjesshme ose studimet që përmbajnë më pak se kreditit e plota, do të njihen sipas rastit

Arsimi i lartë duhet të dokumentohet sa më mirë (kërkesat e dokumentacionit):

- Certifikata/diploma juaj e arsimit të lartë dhe transkripti i të dhënave akademike (indeksi/lista e notave /*relevé de notes*) janë dokumente të nevojshme, por normalisht të pamjaftueshme për njohje specifike, pasi Norvegjia do të shikojë çdo lëndë/kurs në arsimin tuaj dhe do t'i krahasojë me lëndët/kurset në arsimin korrespondues që ofron OUC. Prandaj ata ju kërkojnë të dorëzoni programin mësimor/përshkrimin e lëndëve dhe listën e literaturës së rekomanduar, që tregon përmbajtjen, shtrirjen dhe nivelin e çdo lënde/kursi që përbën diplomën/arsimin tuaj
- Për verifikim të identitetit, duhet të përfshini një fotokopje të noterizuar të faqes së informacionit personal (përfshirë fotografinë) të pasaportës tuaj.
- Nëse keni ndërruar emrin, ose nëse është shkruar ndryshe në ndonjë dokument, duhet ta dokumentoni ndryshimin/ndryshimet me një fotokopje të noterizuar të certifikatës së martesës, ose me një certifikatë nga Guvernatori i Kontesë ("*fylkesmannen*") ose regjistri norvegjez i popullsisë kombëtare ("*folkeregisteret*"). Ju lutemi përdorni të njëjtën mënyrë shkrimi të emrit tuaj në të gjitha rastet.
- Gjithashtu ju kërkohet të dorëzoni sa më shumë që të jetë e mundur dokumentacionin e mëposhtëm:
- Informacion i përgjithshëm për nivelin/arsimin tuaj dhe institucionin tuaj të lartë arsimor përfshirë këtu informacion për sistemin e diplomave dhe kërkesave të pranimit
- Shpjegim i sistemit të notave
- Shpjegim i sistemit të kreditëve
- Detyrat/punimet/esetë e shkruara nga p.sh klasat/kurset, seminarët, punët e laboratorit, punët e projektit dhe/ose provimet përfundimtare, dhe detyra të tjera të shkruara më të gjera p.sh disertacion apo mikroteza. Ju lutemi të bëni një përmbledhje (resumé) të detyrave me shkrim ose në norvegjisht, ose në ndonjë gjuhë tjetër skandinave ose në anglisht
- Institucioni juaj i arsimit të lartë duhet të verifikojë që informacioni i referohet arsimimit tuaj në kohën aktuale, dhe jo një periudhë të mëparshme apo më të vonshme. Nëse është e mundur, bashkëngjisni një katalog zyrtar të universitetit ose manual për studentët të kohëve kur ju ishit student
- 11.3. Kërkesa në lidhje me dokumente dhe fotokopje:
- Diploma/certifikata juaj dhe transkripti i të dhënave akademike duhet të dorëzohen si në gjuhën origjinale ashtu dhe të përkthyer në norvegjisht ose në gjuhë tjetër skandinave ose në anglisht. Përkthimet duhet të bëhen nga një përkthyer i autorizuar ose shërbim publik përkthimi. Nëse është e mundur, dokumentacioni shtesë duhet të dorëzohet në gjuhën origjinale dhe i përkthyer në një nga gjuhët e përmendura.
- Të gjitha fotokopjet duhet të noterizohen si fotokopje të vërteta me origjinalet në çdo faqe (përfshirë dhe faqet e pasme). Kërkohet një vulë zyrtare me datë dhe një nënshkrim plotësisht i lexueshëm. Në përgjithësi, OUC pranon vetëm vërtetësinë nga një autoritet norvegjez i administratës publik, pra vërtetësinë nga një nëpunës agjencie shtetërore, konteje ose bashkiake (p.sh, një institucion arsimor, policia, noteria etj). Fotokopje të kopjeve të noterizuara nuk do të pranohen.
- Nga disa vende (ju lutemi shihni guidën në formularin e aplikimit) OUC kërkon që ju të dorëzoni dokumente origjinale për verifikim. Nëse kjo vlen për ju, sigurohuni që të dërgoni aplikimin dhe dokumentet e bashkëngjitura me rekomandë ("*rekommendert post*"). Dokumentet origjinale do t'ju kthehen. Përpara se të dërgoni dokumentet origjinale, sigurohuni të dini se në cilin fakultet në OUC do të shqyrtohet aplikimi juaj, pasi është e rëndësishme që dokumentet tuaja t'i dërgohen adresës

së duhur në OUC (shihni "Ku të dërgoj aplikimin"). Do të ishte mirë të kontaktoni më përpara me fakultetin.

- Nga disa vende (ju lutemi shihni guidën në formularin e aplikimit) duhet të bëni një kërkesë në universitetin/kolegjin tuaj për të dërguar transkriptin e të dhënave tuaja akademike (indeks/lista e notave/*relevé de notes*) direkt në Kolegjin Universitar të Oslos. Do të gjeni një kërkesë ndërkombëtare për transkriptin dhe do të jepni një formular autorizimi që ta printoni këtu. Përpara se të bëni kërkesën, ju lutemi të siguroheni të dini se në cilin fakultet në OUC do të shqyrtohet aplikimi juaj, pasi është e rëndësishme që dokumentet tuaja t'i dërgohen adresës së duhur në OUC (shihni "Ku të dërgoj aplikimin"). Do të ishte mirë të kontaktoni më përpara me fakultetin.

12. Shërbime mbështetëse për migrantët dhe faqe të tjera të nevojshme interneti

- E përgjithshme: http://www.udi.no/upload/servicesenter_felles/ServiceSenter_engelsk.pdf
- Informacion për Imigrantët e sapoardhur: <http://www.nyinorge.no/>
- Qeveria norvegjeze: <http://www.regjeringen.no/en.html?id=4>
- Ministria e Punës dhe Përfshirjes Sociale:
<http://www.regjeringen.no/en/dep/aid.html?id=165>
- Misionet e shërbimit të huaj: <http://www.norway.info/>
- Shërbimet publike në Norvegji: <http://www.norway.no/>
- Faqja e internetit të Drejtorisë Norvegjeze të Imigracionit:
<http://www.udi.no/templates/Innholdstype.aspx?id=5253>
- Fjalorë në internet për imigrantët në Norvegji:
<http://www.udi.no/templates/PageURL.aspx?id=7731>
- Taksat në Norvegji:
<http://www.skatteetaten.no/Templates/Artikkel.aspx?id=9647&epslanguage=NO>
- Punëdhënës dhe punëmarrës të huaj
<http://www.skatteetaten.no/Templates/Gruppe.aspx?id=9553&epslanguage=NO>
- Aplikim për sigurim gjatë qëndrimit në Norvegji: <http://www.nav.no/omdir/index.html>
- Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq: <http://www.icrc.org/>
- Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM): <http://iom.fi/content/view/64/121/>
- *Amnesty International*: <http://www.amnesty.no/web.nsf/pages/index>
- Listë kontrolli për punëdhënësit dhe punëmarrësit
<http://www.udi.no/upload/Spraak/Engelsk/SjekklisteArbeidsgivereEngelsk.pdf>
- Pyetje të përgjithshme [Norway.no](http://www.norway.no) – porta juaj për në sektorin publik në Norvegji
- Biznesi [Innovation Norway](http://www.innovationnorway.no), [Bedin](http://www.bedin.no) (si të fillohet dhe të drejtohet një biznes në Norvegji)
- Dogana dhe Akciza [Tollvesenet](http://www.tollvesenet.no)
- Kërkim Pune [Organizata Norvegjeze e Punësimit dhe Mirëqenies \(NAV\)](http://www.organizatanorvegjeze.no)
- Autoriteti i Inspektimit të Punës [Arbeidstilsynet](http://www.arbeidstilsynet.no)
- Ministria e Arsimit dhe Kërkimit [Kunnskapsdepartementet](http://www.kunnskapsdepartementet.no)
- Ministria e Shërbimit dhe shërbimeve të kujdesit [Helse- og omsorgsdepartementet](http://www.helse-og-omsorgsdepartementet.no)
- Njohja e kualifikimeve [NOKUT](http://www.nokut.no), [SAFH](http://www.safh.no) – Autoriteti Norvegjez i Regjistrimit për Personelin në Fushën e Shëndetësisë
- Sigurimet Shoqërore Organizata Norvegjeze e Punësimit dhe Mirëqenies (NAV)
- Leje pune dhe qëndrimi [Utlendingsdirektoratet \(UDI\)](http://www.utlendingsdirektoratet.no)

13. Marrja e shtetësisë/kombësisë

Kushtet

Lindja

Në përgjithësi, lindja në Norvegji, në vetvete nuk të jep shtetësi norvegjeze. Një fëmijë (i lindur në Norvegji apo diku tjetër) merr shtetësi norvegjeze në lindje nëse:

- babai është shtetas norvegjez; ose

- mamaja është shtetase norvegjeze.

Nga 1 shtatori 2006, ligji nuk kërkon më që babai të jetë i martuar me mamanë. Mamatë norvegjeze kanë mundur të kalojnë shtetësinë norvegjeze automatikisht vetëm që nga 1 janari 1979.

Natyrizimi si shtetas norvegjez

Në parim, është e mundur që të natyralizoheni si shtetas norvegjez pas qëndrimit në Norvegji shtatë vjet gjatë dhjetë viteve të fundit.

- është e nevojshme që të kualifikoheni për qëndrim të përhershëm dhe të mos jeni të dënuar më përpara (nëse i huaji ka qenë i dënuar më përpara, një periudhë "karantine" sipas kimit të kryer duhet të kalojë përpara se i huaji të lejohet të aplikojë për shtetësi)
- shtetas të vendeve të tjera nordike mund të natyralizohen pas një qëndrimi dy vjeçar
- një person i martuar me një shtetas norvegjez mund të natyralizohet pas tre vjet qëndrimi gjatë dhjetë viteve të fundit me kusht që periudha e plotë e rezidentit në Norvegji si dhe periudha e plotë e martesës të jetë e barabartë të paktën me shtatë vjet (Koha e qëndrimit dhe martesës mund realizohet në të njëjtën kohë, në fakt të huajt e martuar me shtetas norvegjezë mund të marrin shtetësinë pas katër vjet martese nëse kanë qëndruar në Norvegji për të paktën tre prej tyre)
- Ky rregull vlen për partnerët bashkëjetues të pamartuar dhe homoseksualët në unione civile
- Ish shtetas norvegjezë mund të natyralizohen pas një vit qëndrimi gjatë dy viteve të fundit

Nga 1 shtatori 2008, një aplikant për shtetësi norvegjeze duhet të japë vërtetim të njohurive ose në gjuhën norvegjeze ose sami ose të japë një vërtetim që ka marrë pjesë në klasa në norvegjisht për 300 orë.

Personat që natyralizohen si shtetas norvegjezë pas marrjes së shtetësisë përgjithësisht pritet të provojnë që kanë humbur ose hequr dorë nga çdo shtetësi që kanë pasur.

Fëmijët nën 18 vjeç bëhen shtetas norvegjezë me natyralizimin e prindërve të tyre nëse kanë qëndruar në Norvegji dy vitet e fundit. (Jo e nevojshme për fëmijët nën 18 vjeç që janë shtetas të një vendi tjetër të Këshillit Nordik)

Procedura e njoftimit për marrjen e shtetësisë norvegjeze

Shtetësia norvegjeze mund të merret me procedurë njoftimi në Drejtorinë e Imigracionit. Kjo është një formë e thjeshtuar e natyralizimit e përjashtuar nga tarifat e aplikimit.

Njësoj si me natyralizimin, një person që bëhet norvegjez me procedurë njoftimi normalisht duhet të heqë dorë nga çdo shtetësi tjetër që ka, përveçse kur përjashtohet nga kjo gjë.

Kategoritë e mëposhtme të personave janë të pranueshme për shtetësi me anë të procedurës së njoftimit:

- Një fëmijë nën 18 vjeç që ka lindur përpara 1 shtatorit 2006 nga një baba norvegjez dhe një mama e huaj që nuk kanë qenë të martuar (nuk kërkohet të hiqet dorë nga shtetësia e huaj)
- Një fëmijë 12-18 vjeçar i adoptuar nga një shtetas norvegjez pas 1 tetorit 1999, por përpara 1 shtatorit 2006 (nuk kërkohet të hiqet dorë nga shtetësia e huaj)
- Një shtetas i një vendi tjetër të Këshillit Nordik që ka jetuar në Norvegji për shtatë vjet
- Një ish shtetas norvegjez i cili që pas humbjes së shtetësisë norvegjeze ka qenë shtetas vetëm i një shteti tjetër të Këshillit Nordik. Nuk kërkohet periudhë tjetër qëndrimi nëse personi është vendosur në Norvegji

Shtetësia norvegjeze me anë të adoptimit

Që nga 1 shtatori 2006 një fëmijë nën 18 vjeç i adoptuar nga shtetas norvegjez fiton automatikisht shtetësinë norvegjeze. Në raste kur fëmijët janë adoptuar jashtë Norvegjisë, kërkohet miratimi i qeverisë norvegjeze.

Humbja e shtetësisë norvegjeze/ Marrja e një shtetësie tjetër

Një shtetas norvegjez që merr vullnetarisht një shtetësi tjetër humbet automatikisht shtetësinë norvegjeze.

Norvegjezë që qëndrojnë përgjithmonë jashtë Norvegjisë

Shtetasit norvegjezë që fitojnë shtetësinë në lindje, por që kanë qëndruar më pak se dy vjet në Norvegji duhet të aplikojnë për të mbajtur shtetësinë norvegjeze përpara së të bëhen 22 vjeç. Aplikantëve nuk u kërkohet të heqin dorë nga shtetësi të tjera, por u kërkohet të tregojnë "lidhje të përshtatshme" me Norvegjinë. Shpesh udhëtimet e shpeshta në Norvegji ose një vit studimi në Norvegji janë të pranueshme.

Shtetësia e dyfishtë

Në përgjithësi, shtetësia e dyfishtë është e kufizuar sipas legjislacionit norvegjez. Megjithatë vlejnë disa përjashtime:

- personat e lindur nga një shtetas norvegjez jashtë Norvegjisë që marrin shtetësinë e vendit të lindjes (p.sh një person që lind nga prindër norvegjezë në Shtetet e Bashkuara)
- personat që lindin nga një prind norvegjez dhe i huaj që marrin gjithashtu shtetësinë e prindërit në lindje (Vlen gjithashtu për fëmijët e lindur përpara 1 shtatorit 2006 të një babai norvegjez dhe një mamaje të huaj të pamartuar që ka marrë me njoftim shtetësinë norvegjeze)
- kur personat që kanë marrë shtetësinë norvegjeze me njoftim ose natyralizim nuk mund të heqin dorë nga shtetësia ekzistuese

Më shumë informacion:

- Drejtoria Norvegjeze e Imigracionit (Shtetësia): <http://www.udi.no/templates/Tema.aspx?id=4480>
- Ligji norvegjez për shtetësinë (në norvegjisht): <http://www.lovdato.no/all/hl-20050610-051.html>